

**TARIFA E PROPOZUAR**

▶ FAQE 6

# Çmimet e reja të energjisë elektrike për vitin 2015

Ere vendos sot. Tabela e plotë e çmimeve të propozuara nga familjarët deri tek institucionet buxhetore



**PROVIMI I SHTETIT**

Testimi i mësuesve, çfarë duhet të dinë arsimtarët për nesër

▶ FAQE 8

**GJYQI**

Banda e Vlorës, Karçini, Mëshillaj dhe Mexha kërkojnë gjykim të shkurtuar

▶ FAQE 15

**DEBATI**

Rama i përgjigjet Dules: Ne jemi shembull në Ballkan për minoritetet

▶ FAQE 2

# SHQIPTARJA.COM

LEKË 30

VITI IV - NR. 287 - E PREMTE - 05-12-2014

Lexoni Dëgjoni Shikoni  
EDICIONI MULTIMEDIAL



Kjo gazetë përdor teknologjinë QR-CODE

**EKSKLUZIVE**

IDEJA E PËRGJITHSHME E FORTIFIKIMIT TË BREZAVE TË MBROJTJES ME PZA, PZAKA DHE MTK

# HAPET DOSJA

## JA HARTA E BUNKEREVE DHE TUNELEVE SEKRETE



Për herë të parë publikohet dokumenti mbi numrin e saktë të planit të fortifikimeve të hartuar nga Enver Hoxha deri në vitin 1983. Në gazetë gjithë shifrat dhe hartat me ngjyra

▶ FAQE 11-12-13

**SATIRË POLITIKE**



NGA ARBEN DUKA

Homoseksualiteti s'është absolutisht një vlerë e shtuar..

▶ Në faqen 20

**KOMENT**



NGA FLORIDA MISHA\*

Kërkimi shkencor dhe analiza bibliometrike

Është e tepërt të përmend në krye të kësaj analize mbi kërkimin shkencor në Shqipëri, pikërisht përcaktimin e tij si baza e arsimit të lartë dhe e edukimit, si motor i inovacionit, i konkurrencës dhe i cilësisë së mësimdhënies.

▶ vijon në faqen 17

**QENDRIMI**

Balla: Basha vodhi 240 mln USD, të rihapen hetimet

▶ FAQE 3

**VENDIMI**

Kushtetuesja rrëzon PD edhe për ligjin e KLD-së

▶ FAQE 4

**ARTE PAMORE**

Kryeministri Rama surprizon me ekspozitë në Paris

▶ FAQE 18

**BMC Blue Medical Center**  
Vizita, Analiza & Diagnostikim  
Të garantuara sipas protokolleve të mjekësisë bashkëkohore nga Blue Medical Center  
**Të parandalosh, më mirë se të kurosh!**  
Adresa: Rruga "Bardhyl" Nr.101, Tiranë  
Tel: + 355 4 2370 668  
Cel: +355 66 20 90 008  
Email: info@bmc.al, www.bmc.al

**ande-lm®**  
Punoni në Hotele Llukozë me 7 YJE, në bollëkun e Orientit, ku Cilësia e Shërbimit arrin Standartet më të Larta Botërore  
Aplikoni për një Karrierë afat-gjatë, në Hotele e Resorte të Lindjes së Mesme, me VETËM 350 Euro kosto.  
Kontaktoni ANDE-LM® në [INFO@ANDE-LM.COM.AL](mailto:INFO@ANDE-LM.COM.AL) dhe 0692021181 tani

# » KUVENDI

**INTERPELANCA** e kërkuar nga kreu i PBDNJ, Vangjel Dule, ka bërë që mes tij dhe kryeministrit të diskutohen veç çështjeve të minoritetit edhe pozicionet në koalicionin qeverisës



**Topi**  
Kemi një parlament që nuk mund të qubet parlament. Opozita ka tradhtuar elektoratin. Mazhoranca nuk mund të qeverisë e vetme. Të dyja kanë faj. Nuk mund të vazhdohet në këtë mënyrë

# Rama dhe Dule përplasen në Parlament për Himarën

## “Po kërkon qiçra në hell, Himara si Tropoja e Kukësi”

JUXHIN MUSTAFARAJ  
TIRANE

Shqipëria është vend që mund t'i jap leksion edhe shteteve të tjera të Ballkanit për mënyrën e bashkëjetesës dhe trajtimit të minoriteteve. Ky ka qenë qëndrimi i kryeministrit Edi Rama, ndaj kreut të PBDNJ-së, Vangjel Dule, për mënyrën e trajtimit të anëtarëve të minoritetit grek në Shqipëri. Debat i cili nisi menjëherë pas përzgjedhjes së 5 anëtarëve të rinj të Këshillit Drejtues të RTSH-së, vijoi më pas për çështjen e Himarës, regjistrimit të popullsisë dhe problemet me tekstin shkollor. Dule theksoi se përzgjedhja e 5 anëtarëve të KD për RTSH, duke mos përfshirë asnjë anëtar të minoritetit është pastër një shenjë se mazhoranca përjashton dhe shkel të drejtat e minoritetit. “Sapo miratuar anëtarët e Këshillit Kombëtar të RTSH që i përkasin mazhorancës. Sapo shkelëm të drejtat elementare të pjesëtarëve të minoriteteve nacionale. Nuk mund të kuotohet një Këshill Kombëtar i RTSH në të cilin nuk përfaqësohet komuniteti i minoriteteve nacionale në një vend.” u shpreh Dule. Ndërkohë kryeministri

Rama i ka kujtuar, aleatit Dule se në ligjin aktual nuk ka asnjë detyrim për pjesëmarrje të përfaqësuesve nga minoriteti dhe gjithashtu asnjë prej personave në garë nuk ishte pjesë e minoritetit grek. “Besoj që duke qenë ndjekës i vëmendshëm i ecurisë së legjislatcionit lidhur me minoritetet Vangjelit si takonte të bënte gabimin që bëri. Vullneti ynë që nganjëherë duhet ti nënshtrohet kandidatëve që mbase s'do t'i kishim zgjedhur me dorë në tërësi por që janë të ardhur nga shprehja e interesit për të

qenë anëtarë të këtij këshilli. Është si të kërkohe një qiçer me një lloj helli që nuk ekziston”, theksoi Rama. Ndërkohë që Himara ka qenë një pikë e panegociueshme për kryeministrin Rama. Kreu i qeverisë madje i ka kujtuar se jo vetëm kreu i PBDNJ-së, por as minoriteti dhe as fqinjët grek nuk duhet të kenë asnjë pretendim për këtë qytet, të cilin Rama e cilësoi të njëjtë me çdo qytet tjetër në Shqipëri. Duke vlerësuar prezencën e anëtarëve të minoritetit grek në Partinë Socialiste dhe Lëvizjen Socialiste për Integrim, Rama i kujtoj Dules se vetë ai kishte devjuar ndonjëherë për të qenë me pushtetin, duke lënë të nënkuptohet koha në të cilën PBDNJ ka qenë në qeveri me Berishën. Megjithatë pavarësisht kundërshtive të theksuara që kanë pasur gjatë interpelancës mes tyre, Rama e Dule ranë dakort në pikën se regjistrimi i popullsisë ishte i bërë pak vite më parë ishte i pasaktë. Ndërkohë që kreu i PBDNJ-së e lidhi regjistrimin me numrin e pasaktë të anëtarëve të minoritetit grek, kryeministri Rama theksoi se “Censusi” u realizua nën ndikimin e një tendence për të ulur numrin e shqiptarëve. Rama ftoi aleatin Dule që për çdo propozim të bashkëpunoj me qeverinë, madje kërkoi që edhe vetë PBDNJ të futet një rrugë të re historike.



### Marrëdhëniet

Kemi pasur solidaritet madje i kemi mbajtur edhe me bukë grekët, njësoj siç na pritën edhe ata në vite të vështira, pavarësisht se e dimë se si janë sjellë



### DEBATET

# Vangjel Dule kërkon respekt për minoritetin grek në Shqipëri

Kryeministri Rama: Për këtë çështje i japim leksione edhe Ballkanit

**— DULE:** Një ligj mbi minoritetet nacionale do të plotësonte vakumin ekzistues ligjor dhe do të qartësonte politikat ndaj minoriteteve. Këto i thotë KE-së, nuk i thotë PBDNJ-ja.  
**— RAMA:** Kemi mundësinë të jemi kryelartë, që në këtë aspekt, askush nuk mund të na japë asnjë leksion.  
**— DULE:** Nëqoftëse juve, vërtet e ndjeni se vendi ynë mund të japë leksion, në lidhje me situatën e të drejtave të minoriteteve,



t'i themi KIE-së, t'ju ftoni të mbani një leksion, me qëllim që edhe ata të mos bëjnë gabime të tilla, në raportimet e tyre.  
**— RAMA:** Ai regjistrim është bërë në kushte të pafavorshme, nga njëra anë me një rezistencë shumë të madhe për një tjetër aspekt, që na bën përsëri në kampion në Ballkan, për deklarinimin e kombësisë. Sa për kampionin nga fundi, mos më provoko, se fole për ekonominë dhe për pensionet

edhe është e vetmja arsye që më ka bërë seriozisht të them që për ne, ndër shumë të këqija që pati kriza ekonomike në vendin fqinj, pati këtë të mirë, që shumë nga ato pensionet abuzive ranë. Kjo është arritje, besoj për forcimin e marrëdhënieve dypalëshe.  
**— DULE:** Himara është një hapësirë dhe nuk ka vend për spekulimet e natyrave të tjera, që ka një prani tradicionale dhe të konsiderueshme të minoritetit etnik grek.



**— RAMA:** Himara nuk është minoritet. Himara nuk është një zonë që duhet trajtuar apo duhet parë, si një zonë ku qenkan prekur të drejtat e minoriteteve dhe në rast se ju keni pretendim për Himarën, unë do t'ju ftoj t'i bashkangjiti Tropojën, Kukësin, Dibërën, Shkodrën, Elbasanin dhe të gjitha me rradhë dhe t'i bënit paketë, siç i kanë bërë paketë, ata që sot mungojnë këtu.

### 5 anëtarët e rinj të Këshillit Drejtues të RTSH:

- Xhemal Mato**  
68 pro, 5 kundër, 6 kundër
- Valbona Sulçe**  
68 pro, 5 kundër, 5 abstenim
- Elidon Haliti**  
70 vota pro, 5 kundër, 4 abstenim
- Xhelil Aliu**  
69 pro, 4 kundër, 6 abstenim
- Vladimir Grosha**  
64 pro, 9 kundër, 5 abstenime

**Spahiu:**

**“Licensimi, me rëndësi për punonjësit social”**

— Gjatë diskutimit të projektligjit “Për urdhrin e punonjësit social”, deputetja socialiste, Klodiana Spahiu ka theksuar rëndësinë e institucionalizimit të këtij profesioni. Ndërkohë, ajo nënvizoi si me rëndësi të veçantë licencimin e punonjësit social dhe futjen e këtij profesioni tek profesionet e rregulluara. Spahiu u shpreh se në këtë formë mbarvajtja e sistemit është e sigurt. Ndërkohë, gjatë diskutimeve për këtë projektligj u përmendën dhe kriteret për punonjësit social, ku pas nivelit 3-vjeçar secili do të marrë një drejtim të specializuar në nivelin master, qoftë ai shkencor apo profesional.

**Qendrimi**



**EMIRIA MRRUKU**  
TIRANE

**T**ë rihapen hetimet nga Prokuroria për rrugën e Durrës-Kukës, kjo ka qenë kërkesa që ka bërë dje Partia Socialiste. Gjatë seancës së djeshme në Parlament, deputeti socialist, Taulant Balla duke iu referuar raporteve të KLSH, ka thënë se rruga e Kombit duhet të regjistrohesh si vjedhja më e madhe në historinë e ndërtimit të rrugëve në vendin tonë. Deputeti socialist u shpreh se kryetari i Partisë Demokratike Lulzim Basha, në atë kohë ministër i Transportit, iu ka shpërtuar për mrekulli hetimeve. Ndërkohë, Balla theksoi se Basha u justifikua gjatë asaj kohe me disa raporte mjeksore, duke mos u paraqitur në Prokurori. Deputeti socialist theksoi se sipas raporteve të KLSH, Lulzim Basha ka vjedhur 240 milion dollar. Gjithashtu në seancën plenare të ditës së djeshme, Balla u shpreh se duhet të nisë hetimi edhe për Ridvan Boden dhe Sherefedin Shehut, si bashkëpunorë të Lulzim Bashës të cilët kanë marrë 60 milionë euro kredi në kundërshtim me ligjin. “Është segmenti rrugor Durrës-Kukës, ku kryetari aktual i SHQUP-it, de jure se de facto është Saliu, është ende i pagyikuar për përgjegjësinë e 240 milionë dollarëve. Ndër-

**Balla kërkon rihapjen e hetimeve për rrugën e Kombit**

**Deputeti socialist: Basha vodhi 240 milionë dollarë, bazuar në raportet e KLSH-së**

kohë, kam këtu dhe një kallëzim penal që dua t’ia kujtoj Prokurorit të Përgjithshëm se nuk flihet më mbi dosje. Kam dosjen e Ridvan Bodes dhe Sherefedin Shehu që bënë të mundur gjetjen e kredisë për rrugën, për këtë rrugë,

për rrugën e Lutit”, deklaroi Balla. Ndërkohë, sa i përket rrugës Tiranë-Elbasan, Balla tha se dhe në këtë rrugë ish-kryeministri Berisha ka hedhur para pa projekte për rrugët duke i lënë rrugët “në mes të rrugës”. Sipas deputetit social-

ist po rishikohet marrëveshja, dhe nga 407 milionë dollarë do të kushtojë 300 milionë dollarë. Rruga Tiranë-Elbasan sipas deputetit socialist kur nisi projekti në fillim ishte me dy korsi, e ndërsa pas vizitës së ish-kryeministrit u shtuan dhe dy korsi të tjera. Një tjetër problem sipas tij janë edhe dëmshpërblimi i pronarëve të tokës ku kalonte kjo rrugë.

**LIGJET E MIRATUARA**

Gjatë seancës plenare të ditës së djeshme u miratuan me votat e mazhorancës projektligje si ai për sigurinë e shëndetit në punë, për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, për urdhrin e punonjësit social dhe për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu u miratuan edhe projektligje që ratifikojnë marrëveshje të vendit tonë me Bankën Islamike për aksin Tiranë –Elbasan, me SHBA për zhvillimin dhe qeverisjen e mirë.



**Diferenca**

Kjo marrëveshje ishte për t’u riparë, sepse Saliu kishte planifikuar 100 milionë dollarë më shumë për këtë rrugë. Do diskutojmë këtë marrëveshje për t’u riparë dhe për t’i hequr 100 milionë dollarë. Ndryshojmë vlerën totale nga 407 milionë dollarë, në 300 milionë dollarë.



**Basha**

Kreu demokrat Basha, gjatë kohës kur ishte ministër i Transportit është akuzuar për abuzim me fondet e rrugës së Kombit, por ai nuk i ka pranuar akuzat.



**Balla**

Vjedhja më e madhe në historinë e Shqipërisë me rrugët, është rruga Durrës-Kukës, ku kryetari aktual i SHQUP-it është i akuzuar.

**BRAÇE**



**“Tku koha kur sipërmarrësit ishin të mbrotjur nga pushteti”**

— Deputeti socialist Erjon Braçe, gjatë diskutimit për projektligjin e procedurave tatimore, u shpreh se ka ikur koha kur një grusht sipërmarrësish hanin në kurriz të të tjerëve, vetëm se ata ishin të lidhur me pushtetin. Deputeti socialist, u shpreh se ndryshimet në këtë ligj sjellin lehtësime të mëdha për biznesin dhe rrisin transparencën. Ndërkohë, Braçe theksoi se ndryshimet në ligjin e procedurave tatimore ulin nivelin e gjobave në 60%.

**PROJEKTVENDIMI**

**Kuvendi i hap rrugë zëvendësimit të Elivar Golemit**

**Mazhoranca miraton procedurën për përzgjedhjen e Inspektorit të BSH**

**D**eputetët e mazhorancës miratuan dje në seancë plenare, projektvendimin për procedurën paraprake për përzgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë. Në këtë mënyrë në Kuvendi i hap rrugë zgjedhjes së Inspektorit të ri të Përgjithshëm në BSH, që do të zëvendësojë në këtë detyrë Elivar Golemin. Dy ditë më parë ky projektvendim u miratua në Komisionin e Ekonomisë dhe tashmë

pritet të pasohet me zyrarizimin e kandidatëve për këtë post. Ndërkohë mazhoranca ka miratuar pak javë më parë edhe projektvendimin për procedurën për zgjedhjen e dy anëtarëve të rinj të Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë. Në mesin 54 pika 1 e Kushtetutës thotë: Inspektori i përgjithshëm i Bankës së Shqipërisë emërohet për një afat pesëvjeçar nga Kuvendi, midis kandidatëve që janë shtetas të Republikës së Shqipërisë



dhe ndaj të cilëve nuk vërtohen rastet e parashikuara në mesin 47 të këtij ligji. Inspektori i Përgjithshëm duhet të jetë ekonomist me arsim të lartë dhe të ketë punuar në sistemin bankar jo më pak se shtatë vjet. Inspektori i Përgjithshëm mund të riemërohet. Paga e Inspektorit të Përgjithshëm, shpërblimet suplementare, duke përfshirë çdo lloji kompensimi, si dhe trajtimet e tjera njësohen me ato të zëvendësuesgubernatorit të Bankës së Shqipërisë.

■ **PRETENDIMI I PD**

Ligji i shumicës përjashton kreun e shtetit për zgjedhjen e zv.kryetarit të KLD-së dhe shkel nenin kushtetues të barazisë, ku çdo anëtar i KLD-së mund të zgjidhet zv.kryetar i saj

■ **VLEFSHMËRIA E KËRKESËS**

Duke bojkotuar punimet e Kuvendit për këtë ligj, 1 e 5 e deputetëve nuk e ka të legjitimuar kërkesën për të ankimuar këtë ligj, pasi nuk ka qenë pjesë e diskutimit të tij

# Bojkoti i parlamentit bën të pavlefshme amendamentet e PD

## Gjykata Kushtetuese rrëzoi dje kërkesën e Partisë Demokratike për pezullimin e ligjit të KLD

JUXHIN MUSTAFARAJ  
TIRANE

**B**ojkoti i tejzgjatur që Partia Demokratike i ka bërë Kuvendit, veçskadimit të mandateve të deputetëve po i krijon asaj edhe probleme me vlefshmërinë e kërkesave që ka bërë në Gjykatën Kushtetuese. Dje kjo gjykatë rrëzoi kërkesën e PD për shpalljen e pavlefshme të ndryshimeve ligjore në ligjin për Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Pavarësisht argumentave ligjorë të dhënë nga Partia Demokratike, gjykata vendosi për të mos e marrë parasysh kërkesën e cila sipas përfaqësuesit ligjor në këtë seancë merrte kompetencat e Presidentit të Republikës. "Ligji i shumicës përjashton kreun e shtetit për zgjedhjen e zv.kryetarit të KLD-së dhe shkel nenin kushtetues të barazisë, ku çdo anëtar i KLD-së mund të zgjidhet zv.kryetar i saj", tha dje në seancë Ivi Kasa, përfaqësuesi ligjor i PD. Praktika e mospranimit të ligjeve është një kërkesë e përsëritur e opozitës. Shumë prej ligjeve të miratuara nga qeveria gjatë muajve në të cilat forcat opozitare nuk kanë qenë në Kuvend, janë çuar në Kushtetuese nga Partia Demokratike. Por vlefshmëria e këtyre kërkesave është vënë në pikëpyetje nga vetë anëtarët e Gjykatës Kushtetuese të cilët kanë theksuar se mospërmarrja në parlament dhe mungesa e oponencës që vetë opozita mund t'i bëjë ligjeve në kohën kur ato miratohen, ul vlefshmërinë e kërkesave që vetë PD bën për rrëzimin tyre. Kështu anëtarët i kësaj gjykate, Vladimir Kristo ka kritikuar opozitën për bojkotin e saj parlamentar, duke vënë në pikëpyetje legjitimitetin e deputetëve të opozitës, përsa i përket ankesës së tyre në këtë gjykatë. "Duke bojkotuar punimet e kuvendit për

këtë ligj, mendoni që 1 e 5 e deputetëve (pra ju) e keni të legjitimuar kërkesën tuaj për të ankimuar këtë ligj?! Keni qenë ju pjesë e diskutimit të këtij ligji", ishte pyetja që gjykatësi Kristo i ka bërë deputetit Oerd Bylykbashi në seancë. Ndërkohë që argumentat e dhënë nga deputeti i PD-së, lidheshin me faktin se për aq kohë sa

ata mbajnë mandatin e deputetit përfaqësues në Kuvend, "Ne jemi

■ **Kërkesa**

Kushtetuesja shqyrtim të mërkurën ankimimin e PD për ligjin e Gjykatës Administrative

sot e kësaj dite pjesë dhe në përfaqësojmë popullin, këtë kërkon kushtetuta. Ne jemi në ushtrim të mandatit tonë. Për rrjedhojë ne mendojmë që nuk ekziston asnjë ndalim ligjor për të na ndaluar të ankimojmë ligje", u shpreh Bylykbashi. Ndërkohë që vetë gjyqtari i ka kujtuar deputetit demokrat se partitë politike moderne çështjen e

bojkotit e kanë zgjidhur me statut, ndaj edhe në këtë rast legjitimiteti i ankimimit është vënë në pikëpyetje. Kjo gjykatë dy ditë më parë mori në shqyrtim një tjetër ankimim të Partisë Demokratike, atë për ligjin e Gjykatës Administrative, e konkretisht, pikën që përcakon se ndihmësat e gjyqtarëve zgjidhen nga qeveria.



150

**Kristo:**

Më rezultoi që partitë politike moderne e kanë zgjidhur me statut! Unë po ua them që është me pikëpyetje të madhe legjitimiteti i këtij ankimimi

150

**Bylykbashi:**

Ne jemi pjesë dhe përfaqësojmë popullin, këtë kërkon kushtetuta. Ne jemi në ushtrim të mandatit tonë. Për rrjedhojë s'ka asnjë ligjor që na ndalon

**GAF**

**PD s'di kë akuzon, s'njeh kreun e OSSHE**



— Partia Demokratike nuk është e qartë se kë duhet të akuzojë. Gafa e radhës shihet në komunikatën për shtyp në akuzat ndaj kreut të ri të OSSHE, ku në titull e shkruajnë Dritan Çela dhe pak më poshtë në deklaratën për shtyp të Sekretarit të Përgjithshëm Arben Ristani e shkruajnë Ardian Çela. Ndërkohë, opozita pretendon se kreu i ri i OSSHE është nën hetim nga prokuroria e Durrësit. Ndaj kësaj deklaratë ka reaguar kryeministri Rama ku i ka cilësuar akuzat si sajesë për luftë politike. "Të vendosësh në krye të OSSHE sot një individ nën akuzë penale është e pa-justifikueshme, po ta sajosh këtë për luftë politike çfarë është?", shkruan Rama rrjetin social "facebook".

VIDEO/VIHEN NË PIKËPYETJE ANKIMIMET E PD NË KUSHTETUESE

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të A1REPORT që shkarkohet falas

**Burgosja 5 vjeçares**

# Rama: Burgosja e fëmijës, krim, PD kërkon hetimin e autorëve

— Kryeministri Rama e ka konsideruar krim praninë e një fëmije 5 vjeçar në qeli së bashku me nënën e tij. Përmes një postimi në rrjetet sociale kryeministri Rama e ka cilësuar fenomenin e dërgimit në qeli të një vajze të mitur si krim, ndërsa ka dënuar ashpër sajesën e ngjarjeve të tilla nga ana e PD. "Të fusësh në qeli një fëmijë është krim, po të bësh politikë, duke sjaur monstruozitetet të tilla çfarë është?!..." shkruan Rama. Ndërkohë Partia Demokratike ka vijuar të akuzojë qeverinë,

për këtë rast të cilin e ka denoncuar dy ditë më parë në të cilën është shoqëruar në policinë e Tiranës një vajze 5 vjeçare së bashku me nënën e saj, për shkak se kësaj të fundit i ishte zbuluar lidhje e paligjshme e energjisë. Këshilltari ligjor i PD, Gazmend Bardhi në një dalje për mediat i ka kërkuar Prokurorisë nisjen e hetimit lidhur me këtë rast. Sipas PD kjo është një shkelje e Kushtetutës, Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, Konventës Për të Drejtat e Fëmijëve, të Kodit

të Procedurës Penale dhe Ligjit për Policinë e Shtetit. Sipas Bardhit, në çdo vend tjetër, në një rast të ngjashëm do të ishin angazhuar të gjitha strukturat e shtetit për të marrë masa ndaj përgjegjësve, ndërsa në vendin tonë, qeveria dhe konkretisht kryeministri Rama vijon të sulmojë opozitën. Kujtojmë se ngjarja është pranuar edhe nga Ministria e Brendshme, por sipas saj, gruaja kishte kërkuar që ta merrte vajzën me vete, sepse nuk kishte ku ta linte.

Përplasja  
TIRANE

## Nishani 'riciklon' gjyqtarët e rrëzuar, edhe ata kandidatë

Vendet vakante në Gjykatën e Lartë, aplikimet deri në 15 dhjetor

Presidenti Nishani përmes një komunikate për shtyp, ka njoftuar vijimin e procedurave për plotësimin e dy vendeve vakante në Gjykatën e Lartë. Në komunikatën e Presidentit Nishani, ftohen të gjitha subjektet e interesuara të dorëzojnë kërkesën e tyre për të qenë anëtarë të Gjykatës së Lartë, duke nisur që nga data 5 deri më 15 dhjetor të këtij viti. "Në vijim të procedurave (të cilat filluan më datë 10 tetor 2013 dhe vijuan më tej me datë 20 janar) për përzgjedhjen e kandidatëve për dy vende vakante në Gjykatën e Lartë, si dhe me qëllim plotësimin e listës së konkurrenuesve me prurje të reja, ftohen subjektet e interesuara të paraqesin kërkesën për t'u përzgjedhur si anëtarë të Gjykatës së Lartë. Afati për të paraqitur kërkesat për kandidatët e rinj fillon ditën e premtë, datë 5 dhjetor 2014 dhe përfundon ditën e hënë, datë 15 dhjetor 2014", thuhet në komunikatën për shtyp të dalë nga zyra e Presidencës. Të interesuarit për këtë post duhet të dorëzojnë në Presidencë një kërkesë me shkrim, fotokopje të dëshmisë së arsimit të lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë (e noterizuar), përmbledhje të karrierës profesionale e shoqëruar me vërtetimet e lëshuara për çdo rast nga institucioni ose organi ku ka ushtruar detyrën, ose nga Dhomat Kombëtare të Avokatisë, Noterisë, Përm-

## Procesi



## Afati

"Afati për të paraqitur kërkesat për kandidatët e rinj fillon ditën e premtë (sot), datë 5 dhjetor 2014 dhe përfundon ditën e hënë, datë 15 dhjetor 2014", thuhet në njoftim.



## Rikthimi

"Dokumentacioni i kandidatëve, që plotësonin kushtet ligjore në dy shpalljet e mëparshme, emrat e të cilëve janë publikuar në faqen zyrtare të Presidencës, është i vlefshëm".



## Dokumentet

"Ata që plotësojnë kriteret e parashikuara nga ligji, duhet të dorëzojnë në Institucionin e Presidentit dokumentacionin e nevojshëm".

## Debatet

## Mazhoranca rrëzoi gjithë kandidatët kreut të shtetit

Mazhoranca më se njëherë i ka kërkuar Presidentit Nishani që kandidatët për anëtar të Gjykatës së Lartë, për vendet e lëna vakante të konsultohet përpara se t'i dekretojë dhe t'i hedhë për votim. Por kreu i shtetit nuk ka munguar që të hedhë emra që nuk janë konsultuar më parë me mazhorancën, duke u përballur më pas me refuzimin e saj në Kuvend. Çka ka sjellë rrëzimin e të gjithë kandidatëve për anëtarë të Gjykatës, ndërkohë që kanë mbetur gjatë tërë kësaj periudhe vendet vakante në radhët e gjyqësorit.

barimit, etj. Njëherësh duhet të dorëzojë dhe një fotokopje të dokumentit të identifikimit (e noterizuar). Ndërsa nënvizohet se dokumentacioni i kandidatëve, që plotësonin kushtet ligjore në dy shpalljet

e mëparshme për këto dy vende vakante, emrat e të cilëve janë publikuar në faqen zyrtare të Presidencës, është i vlefshëm. Aktualisht mazhoranca po përgatit projektligjin për ndryshime në ligjin për

Gjykatën e Lartë. Sipas tij, shumica propozon ngritjen e Këshillit për Emërimet në Gjykatën e Lartë, i cili do bëjë verifikimin e përmbushjes nga kandidatët për anëtarë të Gjykatës së Lartë, të kushteve

ligjore dhe kriterëve objektive e shtesë, dhe renditjes së tyre. Ai krijohet si organ këshillimor për Presidentin dhe do funksionojë pranë Gjykatës së Lartë. Për konsultimin me kreuin e shtetit për anëtarët

e rinj, projektligji thotë se duhet të garantojë një përzgjedhje të përshtatshme mes kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore e kriteret objektive, por duke folur për emra konkretë.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE  
Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit



## NJOFTIM PËR LIÇENSIM

Në zbatim të nenit 16, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" i ndryshuar, të nenit 18 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, të nenit 10 të "Rregullores për Procedurat e Liçensimit Modifikimit, Transferimit të Plote/ të Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave", bëjmë me dije të gjithë personat, institucionet ose shoqëritë e interesuara se: shoqëria "Dragobia Energy" sh.p.k, ka aplikuar në Entin Rregullator të Energjisë për liçensim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, tregëtimit të energjisë elektrike dhe në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

Me vendimet: nr.124, nr.125, datë 01.12.2014 dhe nr.129, datë 03.12.2014, Bordi i Komisionerëve ka filluar procedurat e liçensimit të këtij subjekti në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike; tregëtimit të energjisë elektrike dhe aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

Të interesuarit lidhur me këtë kërkesë mund të drejtohen pranë zyrave të ERE-s në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta" nr. 10, pranë Institutit të Gjeofizikës, Tiranë, brenda afatit të përcaktuar në nenin 10 të 'Rregullores për Procedurat e Liçensimit Modifikimit, Transferimit të Plotë/ të Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave"

KRYETARI I ERE-s  
Petrit AHMETI



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE  
Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit



## NJOFTIM PËR LIÇENSIM

Në zbatim të nenit 16, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" i ndryshuar, të nenit 18 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, të nenit 10 të "Rregullores për Procedurat e Liçensimit Modifikimit, Transferimit të Plote/ të Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave", bëjmë me dije të gjithë personat, institucionet ose shoqëritë e interesuara se: shoqëria "FATLUM" sh.p.k., ka aplikuar në Entin Rregullator të Energjisë për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike dhe në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike.

Me vendimet: nr.121 dhe nr.122, datë 01.12.2014, Bordi i Komisionerëve ka filluar procedurat e liçensimit të këtij subjekti në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike dhe tregëtimit të energjisë elektrike.

Të interesuarit lidhur me këtë kërkesë mund të drejtohen pranë zyrave të ERE-s në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta" nr. 10, pranë Institutit të Gjeofizikës, Tiranë, brenda afatit të përcaktuar në nenin 10 të 'Rregullores për Procedurat e Liçensimit Modifikimit, Transferimit të Plotë/ të Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave"

KRYETARI I ERE-s  
Petrit AHMETI

# ERE vendos për çmimin e energjisë elektrike më 2015

Institucionet buxhetore do të paguajnë më shumë, për familjarët një tarifë: 11.08 lekë/kWh

**GENC KONDI**  
TIRANE

Sot duhet të marrin fund spekulimet lidhur me masën e rritjes së çmimit të energjisë elektrike, për t'i hapur rrugë, ndoshta, betejës në fushën politike lidhur me ndryshimin e mundshëm. Enti Rregullator i Energjisë ka planifikuar në Hotel Tirana seancën dëgjimore me

tre operatorët kryesorë, pas aplikimeve që të tre ata kanë dorëzuar lidhur me tarifat për vitin e ardhshëm.

Dje ERE ka publikuar tabelat e konsoliduara, sipas kërkesave të KESH, OST dhe OSHEE, me çmimin final që mund të rezultojë, në rast se do të miratohen 100% kërkesat e tyre. Në rast se komisionerët e ERE-s bien dakord me kërkesat e ndërmarrjeve të prodhimit, transmetimit dhe

shpërndarjes, tanimë të treja në pronësi të shtetit shqiptar, çmimi përfundimtar për konsumatorët familjarë do të ishte vetëm me një tarifë, 11.08 lekë për kilovatorë, si për ata që konsumojnë më pak se 300 kWh në muaj, ashtu edhe për konsum më të lartë se kaq. Për bizneset që furnizohen me tension të ulët, si familjarët, çmimi do të ishte i diferencuar, nga 9.56 lekë për furrat e bukës, deri tek 15.36 lekë për tregtinë

e shërbimet, gjithnjë vetëm me një tarifë. Institucionet shtetërore do të paguanin më shtrenjtë se të gjithë konsumin e energjisë elektrike, me 17.59 lekë për një kilovatorë.

Kërkesat e të tre operatorëve kanë qenë në rritje, pas një periudhe trevjeçare "moratoriumi", gjatë së cilës nuk ka patur ndryshim çmimi. Kështu, KESH ka kërkuar të mos ndryshohet tarifa për prodhimin e energjisë (1 lekë për kilovatorë), por rritje 51.8 për qind të tarifës së shitjes me shumicë, nga 2.2 në 3.34 lekë. OST gjithashtu ka kërkuar 12.8 për qind rritje çmimi për shërbimin e vet, duke kaluar nga 0.65, në 0.73 lekë.

Së fundi, shitësi me pakicë OSHEE ka kërkuar 38% më shumë për tarifën e shërbimit të shpërndarjes dhe kështu çmimi mesatar funder do të rezultonte me 29.3 për qind rritje. Kërkesat pasqyrojnë një situatë shumë të vështirë, madje prag kolapsi, për gjithë sektorin elektroenergetik shqiptar, me një mal borxhesh të ndërsjellta dhe kredi të rënda nga brenda e jashtë vendit. Opozita po bën presion politik kundër rritjes së çmimit që, në fakt nuk vendoset nga Ekzekutivi, por nga Enti Rregullator, që është një institucion i pavarur parlamentar, që gjykon në rrugë teknike dhe jo politike. Nga ana tjetër, marrëveshjet me FMN dhe Bankën Botërore kanë qenë të kushtëzuara me rritjen e arkëtimeve dhe pagesën e detyrimeve, për çka qeveria ka vënë në lëvizje edhe ndëshkime deri në burgim për debitorët.



**FALJA E 80% TË KAMATËVONESAVE, RADHË TË GJATA DJE NË SPORTELET E OSHEE**

**Struktura e Propozuar e Tarifës për Vitin 2015**

Konsumi Sipas Nivelit të Tensionit në kWh	Çmimi i Propozuar për Vitin 2015 (Lekë/kWh)
<b>Kliente të furnizuar në 35 kV</b>	
Industri	11.07
Tregëti & shërbime	10.91
Bujqësi	10.91
Të tjerë	11.95
<b>Klientë të furnizuar në 20/10/6 kV</b>	
Industri	12.23
Tregëti & shërbime	12.83
Furra buke, prodhim mielli	9.40
Bujqësi	11.26
Të tjerë	12.43
Buxhetorë	14.59
<b>Klientë të furnizuar në TU (0.4 kV)</b>	
Industri	13.51
Tregëti & shërbime	15.36
Furra buke, prodhim mielli	9.56
Bujqësi	13.13
Të tjerë	15.20
Buxhetorë	17.59
<b>Familjarë</b>	
Bloku i parë deri në 300 kWh	11.08
Bloku i dytë mbi 300 kWh	11.08
Ambientet e Përbashkëta Familjar/Privat	11.08
<b>Konsumi Vetjak</b>	
Konsumi Vetjak në TM	12.49
Konsum Vetjak në TU	15.23
Konsum Vetjak në Njësitë e TL	15.23
<b>Çmimi Mesatar i Shitjes me Pakicë të Energjisë Elektrike</b>	
	12.32

## Ambasadori rus: Vendimi për eksportet shqiptare, jopolitik

Deklarata, pas shqetësimit të qeverisë shqiptare për bllokimin e fruta-perimeve



Aleksander Karpushin

**Vezët**

Gjatë një takimi me prodhuesit e vezëve, kreu i Bujqësisë deklaroi se në treg s'ka çmim 30 lekë/kokrra. Prodhuesit thanë se lënda e parë është shtrenjtuar, duke ndikuar çmimin

Vendimi i Rusisë për sanksionet ndaj importit të fruta-perimeve shqiptare nuk është politik. Këtë e ka shprehur dje për "A1 Report" ambasadori rus në Shqipëri, Aleksander Karpushin. Diplomati rus është shprehur se ky vendim është teknik, duke shtuar se mes dy vendeve duhet një marrëveshje tjetër për certifikimin e origjinës së produkteve. Sipas ambasadorit Karpushin, certifikimi i produkteve duhet të bëhet sipas një modeli të ri, ndërsa është shprehur se bllokimi i importit të produkteve shqiptare në Rusi do të vijojë deri në fund të hetimit, edhe pas realizimit të certifikatës së re.

Duke u ndalur tek prodhimet shqiptare, ambasadori rus u shpreh se ato janë shumë të kërkuara në Rusi. Ndërkohë, në një konferencë shtypi, sanksionet e vendosura nga Rusia për fruta-perimet shqiptare, ministri i Bujqësisë Edmond Panariti

i ka cilësuar të padrejta. Ai ka sqaruar skemën që, sipas tij, ka nisur si pasojë e falsifikimeve të markës "Made in Albania" nga një vend i tretë. Panariti tha se ishte pala shqiptare që e evidentoi këtë problem dhe që komunikoi me ambasadorin e Federatës Ruse në Tiranë. "Kjo është një veprë kriminale dhe firmat shqiptare që janë të penalizuar", tha ai.


**Kontrulli i Lartë i Shtetit**

### Kallzohen ish-drejtori dhe dy specialistë të Hipotekës Durrës

Kontrulli i Lartë i Shtetit kallëzoi në Prokurori tre punonjës të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në Durrës. Ish-regjistruesi i Hipotekës në Durrës, Bedri Luku, dhe dy specialistë D.Q dhe K.G.J, njëri me detyrë jurist dhe tjetra me detyrë hartografe, kanë shpërdoruar detyrën në shumë raste, ku spikat edhe regjistrimi i 6.000 metrave katrorë tokë arë në fshatin Arapaj, "aplikuar" nga një person vdekur 14 vjet më parë.

KLSH në zbatim të programit të auditimit ka inspektuar Zyrën Vendore

të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, për periudhën nga janar 2012-korrik 2014. Nga auditimi janë konstatuar një sërë shkeljesh dhe mangësisht, lidhur me zbatimin e procedurave ligjore në pranimin, përpunimin dhe administrimin e të dhënave për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, duke sjellë për pasojë përfitimë pasurore të pamerituara, veprime në kundërshtim me ligjin. Në vijim, KLSH i ka kërkuar Kryeregjistruesit të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme fillimin e pro-



cedurave administrative e ligjore për dhënie e masës disiplinore "Zgjidhje e kontratës së punës" për 2 specialistë e mësipërm të Hipotekës në Durrës.

## Vizita

Toni Blair  
takon qeverinë  
larg syrit  
të mediave



Ish kryeministri Toni Blair, ka vizituar mëngjesin e djeshëm, Tiranën, për një bashkëbisedim me qeverinë Rama, po takimi është mbajtur larg vëmendjes mediatike. Mësohet se ish-kryeministri britanik ka kërkuar që ky takim të mbahet larg syrit të kamerave, prandaj kanë munguar reagimet për mediat nga zyra e kryeministrit, në lidhje me vizitën e tij. Të vetme detaje për këtë takim i ka zbardhur me anë të një fotoje në profilin e tij, zëvendës kryeministri Niko Peleshi. Në foton e tij me Blair si dëgjues ai shkruan: "Një bashkëbisedim interesant dhe i dobishëm i Kabinetit me Tony Blair. Shqipëria e gjeneratës së re përmes reformave të Qeverisë," shprehet numri dy i qeverisë në "facebook". Vizita e Blair, e dyta pas asaj të datës 10 mars 2013, është komentuar dhe nga media britanike, e cila në një artikull të saj flet rreth pagesës që ai merr për këto konsulta si këshilltar i kryeministrit.

# Harito takon Merkel, vendi do dixhitalizoj 1300 shërbime

Ministrja vlerëson përdorimin e teknologjisë, si rrjedhojë e popullsisë së re në Shqipëri

AMBROZIA META  
TIRANË

**S**amiti me temë "Dixhitalizimi i Europës, mundësitë për gjeneratën e re" me pjesëmarrjen e Kancelares gjermane, Angela Merkel dhe ministren tonë të Inovacionit dhe Administratës Publike, Mirela Harito zhvilloi punimet dhe në Berlin. Nga ky samit, ministria Harito nënvizoi rëndësinë e teknologjisë në ndihmë të zhvillimit dhe përmendi faktin që të 1300 shërbimet që ofron Shqipëria po kalojnë në fazë dixhitalizimi. Sipas Haritos, dixhitalizimi i këtyre shërbimeve do sjellë një mënyrë tjetër të të punuarit dhe të shërbimit ndaj qytetarëve. "Teknologjia e informacionit është një mekanizëm që na

**Shërbimet**  
Shqipëria ofron rreth 1.300 shërbime dhe që të gjitha do të kalojnë në procesin e dixhitalizimit duke ndryshuar jo vetëm mënyrën e të punuarit dhe konceptin e shërbimit

ndihmon sot të punojmë dhe të zhvillohemi. Dixhitalizimi dhe teknologjia kanë ndihmuar botën të ndryshojë dhe ky ndryshim është një proces që nuk ka limit. Shteti vetë është tashmë në fazën e dixhitalizimit. Mjafton t'ju përmend se në Shqipëri jemi duke dixhitalizuar të gjitha shërbimet publike. Aktualisht ofrojmë rreth 1.300 shërbime dhe që të gjitha do të kalojnë në procesin

e dixhitalizimit duke ndryshuar jo vetëm mënyrën e të punuarit dhe konceptin e shërbimit ndaj qytetarit," deklaroi Harito. Më tej, ajo theksoi faktin që përdorimi i mjeteve të teknologjisë së informacionit është i lartë në Shqipëri, e kjo si rrjedhojë e popullsisë në moshë shumë të re. "Shqipëria ka një popullsi shumë të re dhe përvetësimi i ndryshimeve teknologjike është i shpejtë. Gjatë takimeve me të rinj në biseda mundohem të nxis marrjen e iniciativës për të punuar duke përdorur mjetet e teknologjisë së informacionit. Në Shqipëri përdorimi i teknologjisë së informacionit është relativisht i lartë dhe në ditët e sotme kur teknologjia ndryshon, profesionet ndryshojnë edhe mënyra e të punuarit ka nevojë të ndryshoj," përfundoi ministria.



Mirela Harito

## TAKIMI

## Tahiri merr mbështetjen nga homologia britanike

Ministri i Brendshëm, Sajmir Tahiri është ndalur në Britaninë e Madhe, në vazhdim të turit të takimeve me autoritetet më të larta, të luftës kundër krimit dhe terrorizmit. Gjatë bisedës me homologen britanike Theresa May, Tahiri ka kërkuar shkurtimin e procedurave për azilkerkuesit dhe mbështetjen për Byronë Kombëtare të hetimit. Nderkohë ministrja May, gjatë fjalës së saj, e cilësoi si të shkëlqyer bashkëpunimin mes dy vendeve dhe vlerësoi punën e qeverisë shqiptare



në luftën kundër drogës edhe krimit. Dy ministrat e brendshëm, nënshkruan një memorandum kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe theksuan faktin që "National Crime Agency" do bashkëpunojë ngushtë me Byronë e Hetimit.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE  
Drejtorja Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit



## NJOFTIM PËR LIÇENSIM

Në zbatim të nenit 16, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" i ndryshuar, të nenit 18 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, të nenit 10 të "Rregullores për Procedurat e Liçensimit Modifikimit, Transferimit të Plote/ të Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave", bëjmë me dije te gjithë personat, institucionet ose shoqëritë e interesuara se: shoqëria "Hidropower Elektrik" sh.p.k, ka aplikuar pranë Entit Rregullator të Energjisë për liçensim në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike dhe në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

Me vendimet nr.116 dhe nr.117, datë 01.12.2014, Bordi i Komisionerve ka filluar procedurat për liçensimin e këtij subjekti në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike dhe të furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

Të interesuarit lidhur me këtë kërkesë mund të drejtohen pranë zyrave të ERE-s ne adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta" nr. 10, pranë Institutit të Gjeofizikës, Tiranë, brenda afatit të përcaktuar në nenin 10 të "Rregullores për Procedurat e Liçensimit Modifikimit, Transferimit të Plotë/ të Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave".

KRYETARI I ERE-s  
Petrit AHMETI



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE  
Drejtorja Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit



## NJOFTIM PËR LIÇENSIM

Në zbatim të nenit 16, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" i ndryshuar, të nenit 18 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, të nenit 10 të "Rregullores për Procedurat e Liçensimit Modifikimit, Transferimit të Plote/ të Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave", bëjmë me dije te gjithë personat, institucionet ose shoqëritë e interesuara se: shoqëria "NOA ENERGY TRADE" sh.p.k, ka aplikuar në Entin Rregullator të Energjisë për liçensim në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike dhe të furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

Me vendimet nr.119 dhe nr. 120, datë 01.12.2014, Bordi i Komisionerve ka filluar procedurat e liçensimit të këtij subjekti në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike dhe të furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

Të interesuarit lidhur me këtë kërkesë mund të drejtohen pranë zyrave të ERE-s ne adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta" nr. 10, pranë Institutit të Gjeofizikës, Tiranë, brenda afatit të përcaktuar në nenin 10 të "Rregullores për Procedurat e Liçensimit Modifikimit, Transferimit të Plotë/ të Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave".

KRYETARI I ERE-s  
Petrit AHMETI

Masat, nuk lejohen celularët, mjetet e komunikimit dhe kopjimi

# Nesër testimi i mësuesve ç'duhet të dinë arsimtarët

Publikimi i rezultateve në 22 dhjetor, më të mirët punësohen

SONILA ISAKU  
TIRANE

## Të dhëna

Nesër 8095 mësues do t'i nënshtrohen testimit të dijeve të tyre për 2200 vende punë në arsim të cilat janë hapur së fundmi pas inspektiveve të kryera nga Ministria e Arsimit. Do të jenë 29 qendra në të gjithë vendin, në të cilat do të organizohet testimi, ndër-kohë që procedura e kryerjes së tij është pothuajse e njëjtë me atë të Maturës Shtetërore. Testi do të jetë i ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë përbën 30 pikë të testit, nga totali me 70 pikë dhe do të ketë pyetje me përmbajtje nga formimi i përgjithshëm i mësuesit, (dokumentacioni), programi, drejtshkrimi i gjuhës shqipe, si dhe komunikimi dhe etika. Ndërsa pjesa e dytë e testit përbën 40 pikë, dhe përmban pyetje profesionale, lidhur me profilin shkencor sipas fushës. Pyetjet e provimit janë hartuar nga specialistë Agjencisë Kombëtare të Provimeve dhe ato do të jenë të njëjta në të gjithë vendin, por sipas profileve ku do të testohen mësuesit. Për të qenë fitues mësuesit duhet të arrijnë mbi 50% të përgjigjeve, ndërsa korrigjimi do të kryhet nga një komision i posaçëm me ekspertët më të mirë të Agjencisë Kombëtare të Provimeve. Publikimi i rezultateve për të gjithë mësuesit do të jetë në 22 dhjetor. Në bazë të këtyre rezultateve mësuesve do t'u bëhet renditja. Ata që do të kenë pikët maksimale do të jenë të parët që do të punësohen në 2200



## Testimi

Mënyra e zhvillimit dhe e administrimit të këtyre provimeve do të jete pothuajse e njëjtë me ato të Maturës Shtetërore, ku kandidatëve do t'u vendosen bar-kode gjatë testimit. Masa do të ketë edhe për administratorët në raste abuzimesh



## Diplomimi

Rezultoni se 60% e aplikantëve janë të gatshëm të shërbejnë edhe jashtë vendbanimit të tyre. Ndërsa 89% e tyre janë diplomuar pas vitit 2000, pra janë mësues të rinj të gatshëm për të shërbyer në cilësi dhe re për shkollat shqiptare.

vendet e shpallura bosh. Në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit sa i përket zhvillimit



të testimit është parashikuar edhe skualifikimi që mund t'u bëhet atyre në raste se shkelet rregullorja e testimit. Kështu një kandidat skualifikohet kur ai tenton të kopjojë apo të marrë apo japë informacion nga një kandidat tjetër gjatë provimit. Po kështu raste skualifikimi janë edhe ku mësuesi gjatë provimit bën komente për përmbajtjen ose zgjidhjen e testit, mban celular apo çdo lloj tjetër komunikimi, plotëson me laps testin, të ndërrojë vendin e përcaktuar, apo të plotësojë në fletën e testit të tjera ushtrime dhe shënime. Kandidati, që ka shkelur një ose më shumë nga pikat e mësipërme, sipas raportimit me shkrim të administratorit përkatës, largohet nga testimi. Sipas udhëzimit, kandidatët, që nuk fitojnë testimin si pasojë e masës disiplinore, nuk kanë të drejtë të aplikojnë për një periudhë një vjeçare.

## Kur penalizohet kandidati

- Kandidatëve nuk i lejohet të marrë ose të japë informacion ose kopje nga një kandidat tjetër;
- Të komunikojë me një kandidat tjetër;
- Të bëjë komente për përmbajtjen ose zgjidhjen e testit gjatë kohës së zhvillimit të testimit;
- Të mbajë celular ose mjet tjetër të teknologjisë së komunikimit dhe informacionit;
- Të plotësojë testin me laps;
- Të shkruajë në fletën e testit ndonjë shënim tjetër përveç atyre që kërkon testi;
- Të ketë me vete materiale të tjera si libra, fletore, fletë të bardha etj;
- Të ndërrojë vendin e paracaktuar.
- Kandidati, që ka shkelur një ose më shumë nga pikat e mësipërme, sipas raportimit me shkrim të administratorit përkatës, largohet nga testimi.
- Kandidatët, që nuk fitojnë testimin si pasojë e masës disiplinore, nuk kanë të drejtë të aplikojnë për një periudhë një vjeçare.

## LAJME shkurt



## Shoqata e transportit paralajmëron protesta

— Pasi nuk kanë marrë asnjë zgjidhje as nga bashkia e Tiranës dhe as nga gjykata, për konkurrencën e pandershme që po ju bëhet nga operatori i dytë i transportit, në linjën Tiranë - Elbasan, Shoqata e Transportit ndërhyrjen e qeverisë. Kujtim Mema, kreu i saj i ka kërkuar kryeministrit Rama që të ndërhyjë, për zgjidhjen e këtij ngërçi pasi operatori i dytë është shpallur nëpërmjet një tendere të pa ligjshëm, për qëllime klienteliste nga ana e bashkisë Tiranë. "Operatori që ka linjën e ka ekskluzive dhe ajo linjë i përket atij, është në ligj të transportit, ashtu dhe në ligjin e Evropës dhe kjo linjë që e ka ai nuk mund të vijë një i dytë. Ngelet që ti drejtohem kryeministrit të kthejë sytë dhe nga transporti qytetas", thotë Mema.



## Energjia, Nikolla inspektive në bashku me kreun e OSHEE

— Ministria e Arsimit dhe Sportit, Lindita Nikolla, ka deklaruar se procesi i ndërhyrjesimit për zbatimin e ligjit fillon që në bankat e shkollës, duke ju referuar në këtë mënyrë respektimit të ligjit për çështjen e energjisë elektrike. E shoqëruar edhe nga administratori i ri i OSHEE, Adrian Çela, ministria nuk ka pa përmendur pensionistët dhe personat me aftësi të kufizuar, si ndër më të rregullit në pagesën e fatuave të energjisë. Nga ana tjetër administratori Çela tha se ka një rritje të numrit të personave që i drejtohen zyrave për të bërë pagesat e detyrimeve të prapambetura, pas vendimit për falje të kamatëvonesave. Ministria Nikolla dhe administratori Çela kanë asistuar në inspektimet e OSHEE dhe Policisë së Shtetit në zonën e "Don Boskos" në Tiranë, për ndaljen e abuzimeve me energjinë elektrike

## Punësimi TIRANE

Derjtuesit e kompanive të cilët nuk paguanjë sigurimet shoqërore për punonjësit e tyre, do të dërgohen në prokurori. Kjo ka qenë deklarata e bërë nga Ministri i Mirëqenies Sociale, Erion Veliaj ndërsa theksoi se nga kontrollet e ushtruara janë verifikuar kompani kryesisht në sektorin e industrisë, të cilat vazhdimisht, edhe pse penalizohen me gjoa nuk derdhin sigurimet shoqërore për pun-

## Nuk paguanjë sigurimet, Veliaj: Kallëzim penal të kompanive

Gjatë një vitit 81 mijë vende punë, 1/3 e tyre janë hapur rishtazi

nonjësit. Ndjekja penale ndaj këtyre kompanive u shpreh Veliaj, do të mbrojtë interesat e punëtorëve. "Ne do ti drejtohem prokurorisë, këtu nuk bëhet fjalë për të shkelur ligjet administrative, nuk bëhet fjalë për të shkelur rregullat e këtij vendi, për të tejkaluar masat administrative siç janë gjobat, po për disa raste ekstreme, ku po përdoret punë skllavëruese pa paguar sigurimet shoqërore duke i thënë tjetrit që do të

paguajë dhe praktikisht duke e vjedhur", tha ministri Erion Veliaj. Nga ana tjetër ai u shpreh optimist edhe rreth punësimeve të reja që po bëhen nga kompanitë. Ai tha se sektori i bankar është ai më i kërkuari ndër-kohë që tha se po krahas miqjes së numrit të punësimeve të reja, po thihet një kontingjent cilësor. "Një nga sektorët që ka rritur punësimin në 10 për qind të të gjithë sektorit ka qenë sektori i bankar. Këtë javë ne do t'negociojmë me

Gjermaninë dhe për punësimin jashtë vendit. Ne kemi pasur kërkesë për punësimin e disa qindra infermierëve shqiptarë të punësohen në Gjermani. Kushtet e ekonomisë ku jetojmë sot duhet të përgatitemi për një treg kompetitiv brenda vendit, po duhet të jemi të hapur dhe për mundësitë që zyra e punës dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit ofron për të punuar jashtë vendit, me parimin "Çdo gjë për punësimin", vijoi



Erion Veliaj

ministri. Sipas ministrit Veliaj, gjatë një viti në skemën e sigurimeve shoqërore janë gjenur mbi 81 mijë vende pune, nga të cilat 1/3 janë vende të reja, ndërsa 1/3 tjetër janë vende të zbardhura nga puna në të zezë.



# Golemi ballë për ballë me prokurorin, veçohet dosja

## Fullani të premtën në prokurori, do merret në pyetje

**Gjyqi**
**ELTON QYNO**  
TIRANË

Dhjetë ish-punonjësit e Bankës së Shqipërisë të arrestuar pas skandalit të vjedhjes së 713 miliard lekëve nga Thesari i Shtetit, do të gjykohen me gjykim të shkurtuar. Kjo kërkesë e bërë prej tyre disa ditë më parë është pranuar dhe nga gjykata e Tiranës, e cila më pas i ka dhënë fjalën prokurorit Ramadan Troci, të lexonte akt-akuzën për të pandehurit, ndërkohë që secën e radhës Troci do japë konkluzionet përfundimtare për të pandehurit: ish-drejtor të Emisionit Dorian Çollaku, Lavdim Cani, Bashkim Xhilaga, Myzejen Belba, Liljana Tusha, Dhimitër Davidhi, Mehdi Marku, Bahri Allushi, Fatbardha Gurthi dhe Gentian Jahja. Në masën e dënimit që prokurori Troci do të japë në pretendencën e tij, do të ketë parasysh përfitimim me 1/3 e



Ardian Fullani



Dorian Çollaku dje në sallën e gjyqit



Elivar Golemi

**VIDEO/ VJEDHJA E THESARIT, HAPET PROCESI GJYQESOR**

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të A1REPORT që shkarkohet falas


**PËRBALLJA E GOLEMIT**

Ish-inspektorja e Përgjithshme e Bankës së Shqipërisë, Elivar Golemi do të gjyko-

uljes së dënimit për çdo nga 10 të pandehurit. Një ulje të tillë ata e përfitojnë edhe nga vendimi i gjykatës që pritet të jepet në muajin janar të 2015.

het në një proces të veçantë gjyqësor, të ndarë nga 14 të pandehurit e tjerë të kësaj banke. Gjyqtari Martin Deda ka pranuar kërkesën e Golemit për një përballje ballë për ballë me prokurorin, por që kjo çështje të gjykohet veçmas me pjesën tjetër të të pandehurve. Në vendimin e saj, gjykata e Tiranës ka ndarë dhe dosjen penale për Petrit Ramohitaj, Ilir Dedjan, Emiljano Lamçe dhe Mehdi Molla, të cilët nuk kanë pranuar akuzën e prokurorisë, duke pretenduar se janë të pafajshëm.

**PYETJA E FULLANIT**

Ardian Fullani, ish-guvernatori i Bankës së Shqipërisë është ftuar ditën e premtë të dëshmojë rreth akuzës së "Shpërdorimit të detyrës". Fullani ditën e hënë u paraqit në prokurori duke respektuar vendimin e Gjykatës së Lartë, që e detyron atë të paraqitet në prokurori çdo ditë të parë të fillimit të muajit. Fullani nuk ka pranuar akuzën e prokurorisë, duke pretenduar se nuk është në kopetencën e tij, që të nxirte rregullore të brenshme për departamentet përkatëse të Bankës së Shqipërisë.

**HETIMET**

Lekët e vjedhura destinacioni në baste



Pritet që brenda muajit dhjetor njësia hetimore Task-Forcë, do dërgojë para gjykatës tre të pandehurit Ardian Bitraj, Kleves Bejtaj dhe MIMOZA BRUZIA. Këta të tre janë të vetmit të pandehurit që prokuroria ka ngritur akuzën e "Vjedhjes së arkave të kursimit dhe bankave" kryer në bashkëpunim vepër penale kjo që ka sjellë pasoja të rënda për buxhetin e shtetit. Ndërkohë prokuroria e Tiranës që po kryen hetime ka bërë me dije përfundimisht se destinacioni përfundimtar i këtyre parave të vjedhura kanë qënë pikat e lotove dhe kazinotë, që frekuentonte i pandehuri Ardian Bitraj. Nga shuma prej 713 mld lekë të vjedhura asnjë kartëmonedhë nuk është gjendur nga prokuroria.


**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE  
Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes se Konsumatorit


## NJOFTIM PËR LIÇENSIM

Në zbatim të nenit 16, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" i ndryshuar, të nenit 18 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, të nenit 10 të "Rregullores për Procedurat e Liçensimit Modifikimit, Transferimit të Plote/ të Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave", bëjmë me dije të gjithë personat, institucionet ose shoqëritë e interesuara se: shoqëria "Future Energy AL" sh.p.k., ka aplikuar në Entin Rregullator të Energjisë për liçensimin në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike dhe të furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

Me vendimet: nr.126 dhe nr.127, datë 01.12.2014, Bordi i Komisionerëve ka filluar procedurat e liçensimit të këtij subjekti në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike dhe të furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

Të interesuarit lidhur me këtë kërkesë mund të drejtohen pranë zyrate të ERE-s ne adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta" nr. 10, pranë Institutit të Gjeofizikës, Tiranë, brenda afatit të përcaktuar në nenin 10 të "Rregullores për Procedurat e Liçensimit Modifikimit, Transferimit të Plote/ të Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave"

 KRYETARI I ERE-s  
Petrit AHMETI

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE  
Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes se Konsumatorit


## NJOFTIM PËR LIÇENSIM

Në zbatim të nenit 16, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" i ndryshuar, të nenit 18 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, të nenit 10 të "Rregullores për Procedurat e Liçensimit Modifikimit, Transferimit të Plote/ të Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave", bëjmë me dije të gjithë personat, institucionet ose shoqëritë e interesuara se: shoqëria "Power Elektrik Sllabinjë" sh.p.k, ka aplikuar në Entin Rregullator të Energjisë për liçensimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike dhe tregëtimit të energjisë elektrike.


Me vendimet nr. 118, dhe nr.115, datë 01.12.2014 Bordi i Komisionerëve ka filluar procedurat për liçensim të këtij subjekti në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike dhe tregëtimit të energjisë elektrike.

Të interesuarit lidhur me këtë kërkesë mund të drejtohen pranë zyrate të ERE-s ne adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta" nr. 10, pranë Institutit të Gjeofizikës, Tiranë, brenda afatit të përcaktuar në nenin 10 të "Rregullores për Procedurat e Liçensimit Modifikimit, Transferimit të Plote/ të Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave"


 KRYETARI I ERE-s  
Petrit AHMETI

18

Korrik të një viti më parë një i ri u tha se përplasi qëllimisht një post-blok policor, pasi efektivët i kishin ndaluar vëllanë. Shoferi u largua në drejtim të paditur



Lajden Kadilli



Pamje nga vendi i ngjarjes

3

Muaj më vonë, 20-vjeçari u arrestua dhe u vu nën një akuzë të rëndë. Nuk dihet ende se si ka fituar lirinë, por ditën e djeshme ka përsëritur sërish aktin e përplasjes së policit

**ARRESTIMI**

**Kadilli prangoset 3 muaj pas ngjarjes**



— Tre muaj pasi tentoi të përplasë me makinën e tij patrullën policore, pasi i vunë gjobë për shkelje të rregullave të qarkullimit, policia e Durrësit arreston 20-vjeçarën, Lajden Kadilli. I riu me banim në Durrës u prangos orëve të mbrëmjes në qytetin e tij pasi ndaj tij rezultonte të ishte ngritur një akuzë shumë e rëndë, policia e Durrësit bëri me dije se në momentin kur shoqërohej me shtetasin Arland Kadiu, të cilit iu gjet një sasi lënde narkotike, Kadilli u vu në pranga. Ndaj tij ishte ngritur akuzë për "Vrasje për shkak të cilësive të veçanta të viktimës e mbetur në tentative", parashikuar nga neni 79/b e 22 i Kodit Penal. Dosja ndaj tij, u tha se u përcoll për tek Prokuroria për Krime të Rënda.

# Polici kërkon ta ndalojë, i riu e përplas me makinë

## Në kërkim Lajden Kadilli, përsëriti aktin e një viti më parë

**NIKOLETA KOVAÇI**  
TIRANË

**N**jë punonjëse policie në Durrës është goditur me një makinë, të cilën e drejtonte një person që njihet prej më shumë se një viti nga policia e këtij qarku. I riu, në fakt nuk dihet se si është konfliktuar me punonjësin e policisë rrugore, por ai e ka përplasur efektivin dhe më pas është larguar nga vendi i ngjarjes. Deri orëve të vonave të mbrëmjes së djeshme, shoferi rebel nuk është arrestuar dot, ndërsa është identifikuar dhe është shpallur në kërkim.

**PËRPLASJA**

Sipas të dhënave që vijnë nga Durrësi bëhet me dije se një drejtues automjeti, jo vetëm që nuk i është bindur urdhrave të policisë rrugore për të ndaluar, por madje e ka përplasur me makinë këtë të fundit

dhe është larguar nga vendi i aksidentit. Ngjarja ka ndodhur në Durrës, ku oficeri i policisë rrugore, Shkëlqim Cupa, i ka kërkuar drejtuesit të automjetit Lajden Kadilli që të ndalojë, por ky i fundit nuk e ka zbatuar urdhrin. Madje, jo vetëm kaq, por Kadilli e ka përplasur me makinë policin rrugor, duke u larguar nga vendi i ngjarjes. Efektivët i policisë, Cupa, është dërguar në spitalin rajonal të Durrësit, ku mësohet se nuk ka pësuar dëmtime serioze dhe ndodhet jashtë rreziqut për jetën. Në vendin e ngjarjes kanë mbërritur forcat e policisë së rendit, të cilët kanë nisur menjëherë punën për kapjen e drejtuesit të automjetit, si dhe zbardhjen e plotë të rrethanave të aksidentit. Për arrestimin e Kadillit mësohet se janë ngritur postbloqe të shumta në të gjithë qytetin bregdetar. Ndërkohë nga verifikimet e kryera, rezultoi se Kadilli këtë ngjarje e ka të përsëritur pasi në korrik të vitit 2013, ka aksidentuar një tjetër oficer

të policisë rrugore, në postblokun e 'Urës së Dajlanit' në Durrës.

**NJË VIT MË PARË**

Lajden Kadilli, sot 21 vjeç, pasditën e 18 korrikut të një viti më parë, desh iu mori jetën një grupi punonjësish

likojë me efektivet. Debatimi mes tyre ka përkeqësuar situatën derisa efektivet e post-blokut kanë kërkuar ndihmën e kolegëve të tyre të komisarariatit. Në fakt ajo ngjarje pati dëshmitarë të shumtë, për shkak të mbipopullimit të zonës dhe të faktit që ishte sezon veror. Policia arreston djalin që replikoi me efektivet, ndërsa Lajdeni, i cili gjendej në timon, sapo i marrin vëllanë, largohet nga vendi i ngjarjes disa metra, kthen makinën dhe vjen e godet efektivet që gjendeshin sërish në rrugë. Mjeti

**PËRBALLJA**

**Oficeri i policisë rrugore, Shkëlqim Cupa, i ka kërkuar drejtuesit të automjetit Lajden Kadilli që të ndalojë, por ky i fundit nuk e ka zbatuar urdhrin**

policie të cilët ishin në një postblok në vendin e quajtur 'Ura e Dajlanit'. Lajdeni po drejtonte makinën në sedjen e parë të së cilës kishte vëllanë e tij, më të madh se vetja. Policia i ka ndaluar vëllazërit Kadilli, ndërsa djali më i madh në moshë ka nisur të rep-

përplas vetëm një nga policët, i cili menjëherë u nis për në spital nga shokët e tjerë. Kadilli u largua nga vendi i ngjarjes, ndërsa dëshmitarë të shumtë thanë se në fakt punonjësit e policisë ishin sjellur mjaft keq me vëllazërit Kadilli.



# Aksidentet rrugore, 2 viktima dhe 2 të plagosur në 24 orë

Drejtuesit e automjeteve largohen nga vendngjarja, ku braktisin viktimat

**Detaji**

**Ngjarja**

Në afërsi të fshatit Reps të Mirditës, teksa tre kalimtarë ishin duke kaluar rrugën kur janë përplasur nga një automjet tip "Fiat", ngjyrë blu, që është larguar nga vendi i ngjarjes. Për pasojë, ka gjetur vdekjen e menjëhershme 18-vjeçarja Gjyste Tusha, ndërsa është plagosur gjyshja e saj Marte Tusha dhe i shoqi Pashk Gjoka.



**D**y viktima dhe një i plagosur është bilanci i një aksidenti që ka ndodhur pasditën e djeshme, rreth orës 16:00 në Rrugën e Kombit. Aksidenti tragjik ka ndodhur në aksin Rrëshen-Kalimash, në afërsi të fshatit Reps të Mirditës, teksa tre kalimtarë ishin duke kaluar rrugën kur janë përplasur nga një automjet tip "Fiat", ngjyrë blu. Për pasojë, ka gjetur vdekjen e menjëhershme 18-vjeçarja Gjyste Tusha, ndërsa është plagosur gjyshja e saj Marte Tusha dhe i shoqi Pashk Gjoka. Marte Tusha ka humbur jetën për shkak të plagëve të marra teksa transportohej për në Tiranë, ndërsa Pashk Gjoka është dërguar në spitalin e Mirditës për të marrë ndihmën e nevojshme nga bluzat e bardha, ku ndodhet në gjendje jo kritike për jetën. Mësohet se

menjëherë pas aksidentit, drejtuesi i automjetit është larguar me shpejtësi nga vendngjarja, por është ndaluar disa minuta më pas nga uniformat blu. I ndaluar, shtetasin Mersin Allaraj është dërguar në komisarariatin e Mirditës për të dhënë dëshminë e tij, ndërsa policia është duke punuar për të zbardhur rrethanat e plota në të cilat ka ndodhur aksidenti.

Një tjetër aksident ka ndodhur në qendër të qytetit të Shkodrës, pranë



Mjeti i aksidentuar

Universitetit, ku ka mbetur i plagosur një 50-vjeçar. I aksidentuari Xhemal Lusha, është përplasur nga një motor, ndërsa po kalonte rrugën për të shkuar në dyqanin e tij. Ashtu sikurse në aksidentin e ndodhur në Rrugën e Kombit,

edhe këtë herë drejtuesi i automjetit që përplasi qytetarin është larguar nga vendngjarja, duke lënë në rrugë 50-vjeçarin e plagosur. Aktualisht, policia ka shpallur në kërkim drejtuesin e motorit dhe po punon për kapjen e tij.

# » DOKUMENTI I PANJOHUR

Objektet	Niveli e matjes	Shuma e përcaktueshme			Brez i parë			Brez i dytë			Brez i tretë dhe në theks		
		Nevojat	Ndërtuar deri në vitin 1983	Abeten për t'u ndërtuar	Nevojat	Ndërtuar deri në vitin 1983	Abeten për t'u ndërtuar	Nevojat	Ndërtuar deri në vitin 1983	Abeten për t'u ndërtuar	Nevojat	Ndërtuar deri në vitin 1983	Abeten për t'u ndërtuar
Axione mbrojtje batelioni	copë	1 245	889	356	584	493	91	407	286	121	254	110	144
Qendra zjarri kundërtanke	"	201 175	161 878	39 297	113 373	100 597	13 382	62 839	48 435	14 404	24 357	12 846	11 511
Pikë drejtimi batelioni	"	17 177	9 824	7 353	10 520	6 258	4 262	4 744	2 694	2 050	1 913	872	1 041
Vendkomandë brigade	"	1 291	686	605	650	426	224	427	189	238	214	71	143
" divisioni	"	101	45	56	50	23	27	34	14	20	17	8	9
Pikë drejtimi brigade	"	26	10	16	5	3	2	15	2	13	6	5	1
" divisioni	"	104	29	75	53	17	36	36	8	28	15	4	11
"	"	24	10	14	11	5	6	9	2	7	3	1	1

Faksimile e vendimit të Këshillit të Mbrojtjes me nr. 13 datë 4 dhjetor 1984 që tregon me shifra gjithë objektet e fortifikimit ndërtuar në Shqipëri deri në vitin 1983, si dhe nevojat që ishin projektuar

## Zbulohet harta e të gjithë bunkerëve dhe tuneleve sekrete

Rregjimi kishte projektuar të ndërtonte 221 143 objekte fortifikuese, por deri në 1983 ishin ndërtuar "vetëm" 173 371. Bie poshtë shifra e fryrë se Shqipëria kishte 700 mijë bunkerë...




Harta që tregon gjithë fortifikimin e Shqipërisë deri në vitin 1983 e ekspozuar në BUNK'Art

ADMIRINA PEÇI  
TIRANE

Një hartë sekrete e ekspozuar për herë të parë në Bunk'Art dhe një vendim i Këshillit të Mbrojtjes i datës 4 dhjetor 1984 zbulon për herë të parë vendndodhjen dhe shifrat reale të bunkerëve dhe të mjeteve të tjera fortifikuese që u ndërtuan gjatë regjimit komunist në gjithë territorin shqiptar.

Harta është ekspozuar në nivelin e pestë të bunkerit antibërthamor të Enver Hoxhës, në dhomën ngjitur me dhomën e diktatorit. Edhe me një sy të shpejtë, kjo hartë të ofron një ide të qartë se në cilat zona strategjike ishte përqendruar vëmendja për fortifikimin e vendit. Në hartë këto zona nxijnë prej shënimeve të topografëve, të cilët përmes shenjave të caktuara kanë shënuar të gjithë fortifikimet si: rajone mbrojtje batalioni, qendra zjarri, qendra zjarri kundërtanke, pika drejtimi batalioni, vendkomanda brigade, vendkomanda divizioni, pika drejtimi brigade, pika drejtimi divizioni.

Ndërsa dokumenti që sjellim sot zbulon për herë të parë për lexuesit se regjimi kishte planifikuar të ndërtonte në të gjithë territorin shqiptar 221 143 fortifikime përmes të cilave do t'i bënte ballë çdo sulmi të mundshëm armik dhe se deri në vitin 1983 regjimi ia kishte dalë të ndërtonte vetëm 173 371 fortifikime. Shifra e saktë del pikërisht nga ky doku-



Nën/Kolonel në rezervë Asllan Zemani

ment që paraqet projektidenë e punimeve fortifikuese miratuar me vendim të Këshillit të Mbrojtjes me numër 13, të datës 4 dhjetor 1984.

Kjo hedh poshtë shifrën e përmendur gjithmonë pas vitit 1991 se Shqipëria kishte ndërtuar gjatë regjimit komunist rreth 800 mijë bunkerë në të gjithë vendin, kur në realitet shifra është shumë herë më e ulët.

### SISTEMI I FORTIFIKIMIT

Për të kuptuar më mirë sistemin e fortifikimit që kishte ngritur Shqipëria gjatë viteve të komunizmit, pyesim nënkolonelin në rezervë Asllan Zemani, i cili thotë për "Shqiptarja.com": "Ishte parashikuar që objektet fortifikuese të ndërtoheshin në tre breza, në të katër anët e vendit, lindje, perëndim, jug dhe veri dhe çdo brez do të paisej me objektet e veta specifike, si në sasi dhe në cilësi, dhe se ndërtimeve filluan me intesitet sipas një radhe të paracaktuar".

Sipas tij, brezi i parë për gjatë gjithë vijës kufitare dhe asaj bregdetare do të paisej me të gjitha llojet e objekteve, sipas armëve dhe shërbimeve, karakteristikë për këtë brez ishte sasia dhe cilësia e objekteve, çdo armë apo mjet do kishte pozicionin luftarak, atë rezervë dhe atë të manovrës. Në të kishte Qëndrat e Zjarrit, Pozicione Zjarri Artilerie, Pozicione Zjarri Artilerie Kundërajrore (PZAKA), strehime, Vend Komanda, Pika Drejtimi Operativ, Pika Furnizimi, Vend Mjekimi për repartet, Vend Servisi për mjetet, Pozicione Kundër Tank, Pozicin Zjarri Tankesh, transhe, hendeklidhje.

Pas këtij brezi fortifikimi, sipas nënkolonelit në rezervë Asllan Zemani, nisi ndërtimi i brezit të dytë. Ai ishte menduar që do zihet nga repartet e skallonit të II dhe u kompletua me të gjitha këto objekte por në një sasi më të vogël.

Ndërsa brezi i tretë u pajis kryesisht me objekte fortifikuese dhe rajone përqëndrimi për njësitë, të cilat qëndronin në rezervë. Në këtë brez kishte objekte kryesisht të tipit tunel

për strehim teknike, shërbimi dhe rezervat luftarake.

### ÇFARË TREGOJNË SHIFRAT E DOKUMENTIT

Ndërsa zbardhim shifrat e të gjithë objekteve fortifikuese, të parashikuara për t'u ndërtuar dhe ato që kishin arritur të ndërtoheshin deri në vitin 1983, vëmë re se një prioritet i madh i ishte dhënë qendrave të zjarrit.

Sipas vendimit të Këshillit të Mbrojtjes ishte parashikuar se në gjithë Shqipërinë nevojiteshin për t'u ndërtuar 201 175 qendra zjarri (bunkerët e zakonshëm në formë kupolash), por deri në vitin 1983 ishin ndërtuar vetëm 161 878 të tilla.

Po ashtu rëndësi e veçantë u ishte kushtuar edhe qendrave të zjarri kundërtanke. Dokumenti i cituar më lart dëshmon se ishte e parë e nevojshme të ndërtoheshin 17 177 qendra zjarri kundërtanke dhe deri në vitin 1983 ishin ndërtuar vetëm 9 824 të tilla.

Por një element i rëndësishëm, siç shpjegon edhe nënkoloneli në rezervë Asllan Zemani, ishte ndërtimi i Vend-Komandave për organizimin dhe drejtimin e luftimeve. Të tilla kishte për çdo repart e nënrepart, ndërsa në brendësi të vendit ishin ndërtuar edhe një sërë Vend-Komandash të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së që u përkasin drejtimeve Operative dhe Strategjike.

Për të gjitha llojet e objekteve u bë një provë të veçantë në rajone të përshtatshme duke bërë përmirësimin e ndryshimit e nevojshme si në formë po ashtu edhe në fortësi.

# IDEJA E PERGJITHSHME E FORTIFIKIMIT TE BREZAVE TE MBROJTJES ME PZA, PZAKA DHE MTK



## Vendkomandë Dvizioni:

- nevojat 26
- ndërtuar deri në vitin 1983 10

## Pikë drejtimi Brigade:

- nevojat 104
- ndërtuar deri në vitin 1983 29

## Rajone mbrojtje Batalioni:


- nevojat 1 245
- ndërtuar deri në vitin 1983 889


## Qendra zjarri:

- Nevojiteshin 201 175
- ndërtuar deri në vitin 1983 161 878

## Qendra zjarri kundërtanke:

- nevojat 17 177
- ndërtuar deri në vitin 1983 9 824





**Shënim:**  
Çdo shenjë e zezë në hartë tregon prezencë e një objekti fortifikues, ndërtuar në territorin e Shqipërisë deri në vitin 1983

Ngjarja



# I sëmuri mendor plagos me thikë dy persona në lokal

## Plagosen pronarja e lokalit dhe një klient, kapet agresori

JULIAN SHOTA  
FUSHË-KRUJË

Vetëm fati dhe klientët e lokalit, kanë mundur të evitojnë një tragjedi të shumëfishhtë në qytetin e Fushë-Krujës. Ka qenë një i sëmuri mendor, i cili gjendej në lokal dhe pas një debati për shkaqe banale me të zonjën e lokalit, ka nxjerrë thikën që mbante me vete dhe ka qëlluar mbi të. Menjëherë është ngritur klienti që ka qenë më afër banakut për të bërë të mundur heqjen e thikës nga duart e personit që njihet për problemet e tij mendore. I armatosur është kthyer dhe ka qëlluar edhe klientin. Burrin ka tentuar ta godiste në pjesën e fytyrës, por, për fat, ai ka lëvizur kokën dhe thika e ka kapur në mjekër. Neutralizimi ka ndodhur nga klientët e tjerë të lokalit të cilët kanë mundur t'i heqin thikën nga duart ndërsa autori ka mundur të dalë nga lokali. Ai është vënë në prangat e policisë, ndërsa dy të plagosurit janë dërguar menjëherë në spital. Mësohet se që të dy janë jashtë rrezikut për jetën, ndonëse gruaja ka marrë plagë në pjesën e shpatullës.


### NGJARJA SIPAS POLICISË

Shkëlqim Curraj, rreth 37 vjeç, mësohet se njihet në lagjen 'Partizani' të Fushë-Krujës si një person i dhunshëm

### Ekspertët

#### Ngjarja

Policia është njoftuar se në lagjen 'Partizani' një njeri i armatosur me thikë po sulmonte njerëzit në një lokal. Policia është nisur për në vendngjarje dhe prangos autorin



#### Autori

Sipas të dhënave të policisë mësohet se autori i sulmit është një 37-vjeçar me probleme mendore. Autori kishte marrë me vete një thikë të madhe dhe e mbante në lokal



Pamje nga vendi i ngjarjes

### Plagosja

Shkëlqim Curraj ka goditur fillimisht të zonjën e lokalit, Servete Kazium dhe më pas qëlluar edhe një klient i cili është ngritur të shpëtonte gruan e plagosur nga i sëmuri

### Rrëfimi

#### Klienti: Pata frikë se do më vriste

— Petrit Gjini, 60-vjeçari që ka shpëtuar mrekullisht nga goditja e thikës së personit të sëmuri mendor ka rrëfyer për policinë gjithë skenën që për pak sa nuk është kthyer në një masakër. Ai ka treguar edhe se si ka mundur të evitojë goditjen në fytyrë, duke i thënë policisë se: U tremba se do më priste në qafë. Ai është njeri me probleme mendore, për pasojë është shumë i fuqishëm dhe në momente të caktuara nuk e di se çfarë bën. Ndaj pata frikë se do më godiste në qafë". Policia ka vënë në pranga autorin dhe ka sekuestruar edhe thikën që mbante me vete në kafene.

herë pas here. I riu mësohet se ka probleme me shëndetin mendor, por sipas të dhënave, ai sa herë që është nën efektet e alkoolit bëhet edhe më i dhunshëm. Kështu ka ndodhur edhe ditën e djeshme, në kohën kur ai ka qenë duke pirë në lokalin në pronësi të

Servete Kazium, 58-vjeçares, e cila shërben edhe në banakun e lokalit të vet. Curraj është ngritur nga tavolina ku ka qenë i ulur dhe është nisur në drejtim të tualetit të lokalit. E zonja e lokalit e ka vënë në dijeni se nuk mund ta përdorte tualetin pasi nuk

kishte ujë. Por Curraj është nevrizosur dhe menjëherë është kthyer dhe ka sulmuar me thikë gruan. Goditja e ka kap në pjesën e shpatullës, pasi gruaja ka qenë brenda banakut. Në moment është ngritur 60-vjeçari, Petrit Gjini, me qëllim për ta spos-

tuar djalin e armatosur. Curraj ka nisur goditjen tjetër në drejtim të personit që po i afrohej. Ai ka tentuar ta qëllojë në pjesën e fytyrës por thika e ka goditur në mjekër, ç'ka ka bërë të mundur që Gjini të shpëtojë mrekullisht nga goditja fatale. E zonja e loka-

lit, mësohet se pas marrjes së mjekimeve të para është nisur me urgjencë në drejtim të Spitalit Usharak për mjekim më të specializuar, ndërsa Gjini, pas mjekimeve të polici ky ka rrëfyer edhe të gjitha detajet e ngjarjes së rëndë.

# Zhduken armë nga stacioni policor i Anderlehtit

## 3 pistoletë dhe 2 anti-plumb ngrënë në këmbë policinë e Belgjikës



Një akt i çuditshëm është raportuar ditëve të fundit nga mediet belge në lidhje me vjedhjen e disa armëve në stacionin qendror të policisë së Anderlehtit. Ngjarja, e cila mendohet se ka ndodhur në muajin e Nëntorit, ka alarmuar policinë vendase, pasi ka dyshime që armët janë zhdukur nga godina policore me porosi të shqiptarëve. Ndonëse në media flitet se vjedhja mund të jetë e brendshme, pasi nuk rezultojnë gjurmë të personave të jashtëm, alarmi është lëshuar pas hetimeve intensive të cilat kanë hedhur dyshime se armët e vjedhura mund të jenë porosi të shqiptarëve. Sipas medieve vendase saktësohet se në dhomën e armatimit të godinës policore janë zhdukur tre armë të tipit 'Glock', dy jeklekë anti-plumb dhe një sasi gazi lotsjellës. Gjatë hetimeve është mësuar se në fakt nuk ka patur hyrje të dhunshme në dhomën e armatimit të ndërtesës, ndër-

sa dyshohet se gjithë armatimi të jetë shitur në vlerën e 4 mijë euro-ve, shumë kjo që sipas medieve, mund të kushtojnë pajisjet. Policia mësohet se ka emra të dyshuar për aktin e vjedhjes së armëve, duke hedhur dyshime te punonjësit të brendshëm, ndërsa shqetësimi kryesor tashmë lidhet me identifikimin e personave që kanë mundësitë për blerjen e armëve. Ata i druhen ndonjë sulmi me armë ndërsa mediet kanë ngritur publikisht dyshimet se ai akt mund të jetë porositur nga shtetas shqiptarë, të cilët edhe mund të jenë poseduesit e pajisjeve të nxjerra nga godina policore.



**Hetimet**  
Gjatë hetimeve është mësuar se në fakt nuk ka patur hyrje të dhunshme në dhomën e armatimit

### Aksioni

## Evidentohen 30 persona si vjedhës të energjisë

— Policia e Shtetit në bashkëpunim me OSHEE, kanë vijuar punën e përbashkët në të gjithë vendin për evidentimin dhe vënien para drejtësisë të autorëve të vjedhjes së energjisë elektrike, si dhe për ndërprerjen e lidhjeve të paligjshme të energjisë elektrike. Në të gjithë vendin gjatë ditës së sotme, kanë vepruar 110 grupe të përbashkëta Polici-OSHEE. Si rezultat i kontrolleve të kryera në terren në abonentët biznes dhe familjarë, janë evidentuar 30 raste të vjedhjes së energjisë elektrike me 30 autorë. Nga këta janë arrestuar në flagrancë 17 persona të cilët akuzohen për vjedhje të energjisë elektrike. Është arrestuar për vjedhje të energjisë Drejtori i OSHEE në Tropojë. Janë



shpallur në kërkim 5 persona, si dhe ndien në gjendje të lirë 8 persona të tjerë. Janë kryer kontrolle të përbashkëta Polici-OSHEE në 1.866 raste, si dhe janë ndërprerë 1.175 lidhje të paligjshme të energjisë dhe abonentëve debitorë. Po gjatë ditës së djeshme janë kontrolluar 119 kabina elektrike dhe abonentët që furnizohen nga këto kabina.

**Pretenca**  
KORÇË

# Vrau 4 persona për dashurinë burg përjetë Bashkim Latollarit

Prokuroria jep pretendën për vrasësin e Gjonomadhit

**B**ashkim Latollari, njeriu që ekzekutoi katër persona në fshatin Gjonomadh të Korçës, rrezikohet të dënohet me burg përjetë. Këtë masë dënimi e kërkoi në seancën e djeshme prokurori Elion Mustafaraj, i cili teksa ka lexuar pretendencën e tij, i ka pohuar gjykatës

që të deklaronte fajtor të pandehurin dhe ta dënonte atë me burgim të përjetshëm. Sipas akuzës Latollari ka kryer një krim shumë të rëndë, pasi në 7 janar 2014, ai me një armë zjarri që mbante pa leje ka vrarë për motive të dobëta shtetasit Beliman Meçollari, Manjola

Meçollari, Rexhep Metellari dhe Valentina Metellari. Konkretisht, i pandehuri deklaroi se kishte patur për disa vite me rradhe një lidhje jashtëmartesore me shtetasen Manjola Meçollari, fakt ky i konfirmuar edhe nga tabulatet telefonike dhe mesazhet e nxjerra

pas ekspertimit kompjuterik të telefonave. Kjo lidhje ishte prishur kohët e fundit. Për prishjen e saj i pandehuri fajësonte shtetasen Valentina Metellari. Viktimat ishin lidhje e afërt me tyre. Shtetasia Beliman Meçollari ishte bashkëshorti i shtetasen Manjola Meçollari.



Bashkim Latollari

**Gjyqi**

ELTON QYNO  
TIRANË


**J**anë "thyer" që në seancën e dytë tre të pandehur të bandës së tritolit në Vlorë, mes tyre dhe biznesmeni i gazit Ilir Karçini. Ky i fundit i akuzuar për pagimin me 150 mijë euro të Julian Sinanaj për vrasjen e biznesmenit të gazit Pirro Bare, ka kërkuar gjykim të shkurtuar, me qëllim përfitimin e uljes së dënimit me masën 1/3. Fill pas kësaj kërkesë të bërë nga avokati i Karçinit, Theodor Sallaku, avokatët e dy të pandehurve të tjerë Albin Mexha dhe Andon Mëshillaj, i janë drejtuar me një kërkesë të njëjtë trupit gjyqës, duke kërkuar gjykim të shkurtuar. Mëshillaj akuzohet për vepra të rënda penale për të cilat nëse shpallet fajtor mund të dënohet me burgim të përjetshëm. Para gjykatës Mëshillaj ka pohuar se ishte dakort me kërkesën që avokatët e tij bëjnë, por ai nuk pranonte asnjë nga akuzat dhe thëniet e të penduarve Julian Sinanaj dhe Ndrëçim Gjokona, për veç vrasjes së peshkatarit njëherësh kushëriut të tij Sokol Veizi. Akuzën e tregtimit të armëve dhe municioneve luftarake nuk e ka pranuar dhe i pandehuri tjetër Albin Mexha, por ky i fundit tha se kërkonte gjykim të shkurtuar për të shpejtuar procedurën e gjyqimit ndaj tij. Lidhur me këtë kërkesë Gjykatat e Krimeve të Rënda, pritet të shprehet në 11 dhjetor për të pranuar ose jo kërkesat ndaj tre të pandehurve. Veç kësaj Karçini, Mëshillaj dhe avokatët e Albin Mexhajt, kanë kërkuar ndarjen e dosjes dhe veçimin e saj për tre të arrestuarit. Por kjo kërkesë është kundërshtuar nga prokuroria me pretendimin se ngjarjet janë të lidhura me njëra-tjetrën dhe smund të gjykoen veçmas.



Andon Mëshillaj dhe në rreth Albin Nezhaj

# "Thyhen" tre të pandehur, kërkojnë gjykimin e shkurtuar

Marjon Mitro dhe Genis Mëshillaj në mungesë të vetmit që do përballesh me dy të penduarit



Ilir Karçini

**GJYKIMI I ZAKONSHËM**  
Momentalisht gjykim të zakonshëm në këtë dosje duket se do të zhvillojë vetëm dy të pandehurit Marjon Mitro dhe Genis Mëshillaj, ky i fundit i shpallur në kërkim ndërkombëtar nga prokuroria. Biznesmeni Mitro, nuk ka pranuar akuzën e planit për të vrarë shtetasin Julian Metushaj, porositjen e vendosjes së tritolit në banesën e Ardian Kol-

lozit dhe vendosjes së tritolit në makinën e ish-prefektit të Vlorës Besnik Dervishaj. Në dëshminë e tij, i penduari Ndrëçim Gjokona ka treguar se teksa qëndronte i izoluar në burgun 313 në Tiranë, Marjon Mitro i ka ofruar apartament në Vlorë dhe

133 DËSHMITARË  
Biznesmenit të njohur në Tiranë, Durrës, Vlorë si dhe zyrtarë të lartë të shtetit, janë përfshirë në listën me 133 emra si dëshmitarë që do paraqiten para gjykatës për të dëshmuar në procesin kundër grupit

kriminal që lidhte "kontratë e vdekjes". Mes personave që do dëshmojnë janë dhe ish-efejuarja Julian Sinanaj, Denada Çuni, biznesmeni i ndërtimit Tanush Mëshillaj, Pirro Bare, ortaku i Marjon Mitros në biznes Andrea Petani, ish-kandidati për deputet i PD në Vlorë, Ardian Kollozi, ish-prefekti i Vlorës Besnik Dervishi, Julian Metushi, e shumë personazhe të tjerë. Lista e 133 dëshmitarëve është vetëm e prokurorisë, pa përf-

**VIDEO/ TRE TE PANDEHUR, GJYKIM TE SHKURTUAR**

Për të parë videon në smartfonin tuaj skanoni QR CODE me APP të A1REPORT që shkarkohet falas

**DREJTORI ZOTO**

S'ka amnisti, për të dënuarit në fundvit



— Pavarësisht kërkesave të dënuarve që nodohen në burje dhe problemit shqetësues të mbipopullimit, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve thotë se nuk do të ketë amnisti për festat e fundvitit. Për të lehtësuar mbipopullimin e theksuar tashmë në burje, ku brenda hekurave ndodhen rreth 1700 persona mbi kapacitetin e lejuar. Si dhe për të krijuar sado pak hapësira në paraburgimet e Tiranës, burgjet kanë transferuar të gjithë femrat që ndodheshin në paraburgimet "Jordan Misja" pranë burgut të grave në "Ali Demi". Ky kamp do të ketë brenda murit rrethues vetëm femra. Ndërkohë mesditën e së enjtës, në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë u nënshkrua një memorandum mes Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe institucionit të Shërbimit të Proves, për të informuar të dënuarit për masat alternative të dënimit, përveç asaj të izolimit në burg.

shirë këtu dhe emrat e tjerë të njohur që do thirren në gjykatë nga avokatët mbrojtës për të dëshmuar në gjyqin e 7 personave të arrestuar për një sërë akuzash shumë të rënda.

**LAJME SHKURT**



**Punonjësi i SHISH, kanos me armë qytetarin**

— Policia nisi procedim penal për një punonjës të shërbimit informative, i cili kërcënoi me pistoletën e shërbimit një qytetar. Burime pranë uniformave blu thanë se oficeri me iniciale S.S banues në Yzberisht debatoi ashpër me një 49-vjeçar në Tiranë. Nga të dhënat e policisë bëhet me dije se oficeri i shërbimit ka qenë në gjendje të dekur kur është konfliktuar me Astrit Lokën dhe në debat e sipër ka nxjerrë pistoletën duke kërcënuar me jetë 49 vjeçarin.



**Shembet urra, izolohen 15 familje në Lezhë**

— 15-familjet të një lagjeje të fshatit Gryk Manati në Komunën e Kolshnit në Lezhë janë izoluar plotësisht për shkak të shembjes së urës. Prurjet e përroit nga reshjet e dendura të shiut 20 ditë më parë e shkatërruan plotësisht urën që ishte ndërtuar me kontributn e vetë banorëve, ndërsa askush nuk ka marrë asnjë masë për të ndërtuar një urë tjetër. Banorët thonë se nuk kanë asnjë mundësi komunikimi me qendrën e fshatit, ndërsa fëmijët e tyre nuk kanë mundësi që të frekuentojnë shkollën prej 20 ditësh

# » INTERVISTA

**PROCESI** i fundit e ndoshta më delikati është ai i dhurimit të karrigeve. Sigurohemi mbi të gjitha që këto karrige të shkojnë pikërisht aty ku duhet, te ata që kanë më shumë nevojë



që një projekt i tillë ekziston. Duhet sqaruar me detaje se kush ishim dhe pse e bënim, cilat ishin përfitimet tona. Shumë persona ishin skeptik... Që të ishim gjithnjë e më pranishëm e mëtej të besueshëm, hapëm një organizatë e quajtur Organizata e Solidaritetit Rinor (OSR), e cila do të kishte si synim aktivizimin, nxitjen dhe integrimin e të rinjve në jetën sociale, ekonomike, humanitare e kulturore. Fuam të rinj të moshës së gjimnazit e universitetit të na bashkoheshin në nismën tonë e që aty gjërat ishin më të thjeshta. Vullnetarët u shtuan jashtë mase aq sa tani jemi në të gjithë qytetet kryesore në vendin tonë e ku numërojmë më shumë se 3500 aktivistë. Vendet nga ku grumbullonim nuk ishin më vetëm shtëpitë tona me konsumin e përditshëm, por edhe kafenet apo restorantet, institucionet publike apo private, ambasadat, bankat etj. Përmes personave dashamirës gjetëm magazina për grumbullimin e kapakëve, të cilat ishin kate apo dhoma të pashfrytëzuara, garazhe, oborre, bodrume. Është një ndjesi tepër e ëmbël, kemi mbetur të mahnitur. Veç atyre që jepnin kontributin e tyre për grumbullim e magazinim kemi patur edhe raste ku familjarë të ndryshëm na kanë dhënë karriget me rrota të cilat nuk duheshin më për të na lejuar ne t'i dhuronim te personat më në nevojë. Mundësuar pas shumë përpjekjesh të bënim dhe dicka edhe më të madhe, të riciklonim këtu, në vendin tonë. Procesi është bërë edhe më i shpejtë në rezultate, të cilat janë mëse të dukshme: vjet në këtë kohë mundëm të dhuronim vetëm dy karrige, tashmë kemi marrë edhe 30 të tjera të cilat do të shpërndahen këto ditë, sasi kjo që do të thotë rreth 8 ton kapakë plastikë. Procesi i fundit e ndoshta më delikati është ai i dhurimit të karrigeve. Sigurisht, që ne kemi një listë pritjeje duke marrë parasysh edhe sugjerimet e vullnetarëve tanë, por sigurohemi mbi të gjitha që këto karrige të shkojnë pikërisht aty ku duhet, te ata që kanë më shumë nevojë. Jemi të pranishëm në shtëpitë e këtyre personave, njohim historitë e tyre, ndajmë eksperiencën dhe ide.

## Ketrin GJERMANI

### Një ditë shpresë dhe gëzim për invalidët

Kordinatorja vullnetare e Tiranës rrëfen qëllimin e projektit 'Albania Cap Project', ndërgjegjësimin mbi riciklimin e plastikës si dhe integrimin e të rinjve në jetën sociale

**IZAURA NDOJ**  
TIRANË

Jemi mësuar të flasim dhe të kemi në fokus të gjitha problemet sociale që na rrethojnë çdo ditë, por harrojmë të kontribuojmë për atë pjesë që ndoshta e vuan më shumë indiferentizimin tonë. Një ditë shpresë dhe gëzim, ka qenë 3 dhjetori për 30 persona me aftësi të kufizuara të cilët janë pajisur me karrica invalidi fal projektit 'Albania Cap Project'. Një nismë kjo e nisur muaj më parë, fal bashkëpunimit mes të rinjve në të gjithë Shqipërinë duke i kthyer buzëqeshjen me një gjest human personave me aftësi të kufizuara. Është pikërisht Kordinatorja vullnetare e Tiranës, Ketrin Gjermani e cila na rrëfen hap pas hapi punën e bërë me riciklimin e tapave, qëllimin e projektit, si dhe nxitjen dhe integrimin e të rinjve në jetën sociale, ekonomike, humanitare e kulturore.

Në ditën kombëtare të personave me aftësi të kufizuara dhuruat 30 karrige me rrota, projekt ky që ka ardhur për shak të mbledhjes së tapave në të gjithë Shqipërinë. Si lindi ideja e këtij projekti? Fillimisht do të doja t'iu falenderoja për interesin e treguar ndaj projektit tonë, e vlerësojmë. Data 3 Dhjetor ishte një ditë e veçantë

për të gjithë ata persona të cilët besuan dhe ndihmuan në realizimin e këtij projekti, më në fund pas më shumë se një viti u mundësua konvertimi i kapakëve plastikë në 30 karrige me rrota përmes riciklimit. Jemi shumë të lumtur e ndihemi krenare. Mënyra se si lindi projekti ishte vërtetë e veçantë. Rreth dy vite më parë, Mimi Barushi, project manager e ACP (Albania Cap Project), ishte në një eorkshop në Kosovë në të cilin do të përcaktoheshin mbajtëset (koshat) për kapakët plastikë. Ishte pikërisht aty që u njoh me këtë projekt interesant. Në

Kosovë, mbledheshin kapakë plastikë e pasi arinin sasinë e 250 kg, dërgoheshin për riciklim. Me sasinë e të ardhurave, bliheshin karrige me rrota të cilat më pas dhuroheshin te njerëzit në nevojë. Projekti ishte i përhapur në atë kohë në 44 vende të botës, ndaj u mendua të bëhej e njëjta gjë edhe këtu. Pasi na u tha si ide, ishim vetëm një grup i vogël me ideale që e përqaftuam këtë nismë me shumë dëshirë.

**Ishte e vështirë për të krijuar një linje zinxhir ku nëpërmjet riciklimit të kapakëve plastikë, mundësohet pajisja me karrica me rrota për personat në nevojë?**

Të them të drejtën, fillimisht ishte tepër e vështirë, ky grup i vogël duhet të bindte këdo



#### Cili është qëllimi i këtij projekti?

Qëllimet e këtij projekti janë dy: Njëri është afat shkurtër, dhurimi karrigeve me rrota për personat në nevojë. Duhet të jemi të vetdijshëm që ka mbi 8.000 persona para dhe tetra-plegjikë të regjistruar e prej tyre rreth 6.000 janë në listë pritjeje. Ne kemi bërë dicka, por ende ka shumë për të bërë. Qëllimi tjetër është afatgjatë e është tejet i rëndësishëm, ndonëse i nënverësuar. Flasin këtu për ndërgjegjësimin për riciklimin. Një kapak i flakur do t'i duhet rreth 450-700 vite për t'u dekompozuar në mënyrë natyrale e dëmet që shkaktohen nga plastika janë të pallogaritshme.

#### Ku synoni të arrini, ndoshta do të jetë një projekt afatgjatë?

Projektet që kemi janë të shumta dhe synimi kryesor i tyre është ndërgjegjësimi. Tani jemi vetëm te kapakët plastikë, por në një të ardhme duam të mendojmë për të konvertuar edhe materiale të tjera që janë të destinuara të hidhen, në materiale të nevojshme për ata që ndoshta nuk gëzojnë të njëjtin fat si ne.

#### Në rrugëtimin tuaj një vjeçar mendoni se keni ndryshuar sadopak mentalitetin e të rinjve të cilët sot, ndikojnë duke ndryshuar sadopak realitetin ku jetojnë?

Është e pabesueshme se sa njerëz dashamirës kemi njohur gjatë rrugëtimit tonë e se sa histori mbreslënëse kemi dëgjuar prej tyre. Kemi parë se si fëmijët ishin ata që nxinin prindërit të bënim dicka. Kemi parë se si shumë e shumë të rinj janë të gëzuar që nuk kalojnë tërë ditën nëpër kafene, por mundohen të ndryshojnë sadopak realitetin ku jetojnë. Jam mëse e sigurt që përmes dëshirës së mirë asgjë nuk është e pamundur. Shohim ndryshim, e shohim këtë në çdo shikim e çdo buzëqeshje të falur.



# Kërkimi shkencor në Shqipëri dhe analiza bibliometrike



NGA FLORIDA MISHA\*

vijon nga faqja 1

Është e gjithëpranuar teza sipas të cilit "nuk mund të ndahet edukimi nga kërkimi shkencor" dhe se kërkimi është një element i domosdoshëm dhe shumë karakteristik.

Universitetet konsiderohen gjithnjë e më shumë si institucionet më të përshtatshëm për zhvillimin e kërkimit shkencor. Dhe kjo për dy arsye kryesore: a) Lidhja e drejt-përdrejtë e kërkimit shkencor me procesin e mësimin; b) Integrimi i kërkimit me një institucion që është më afër tregut të punës së cilët detyrë.

Nga ana tjetër, kërkimi shkencor nuk mund e nuk duhet të bëjë pa komunikimin shkencor. "Komunikimi shkencor është themel, i cili përdoret për të shpjeguar mënyrën se si hulumtuesit/kërkuesit mbasi kanë bërë kërkime, i publikojnë dhe i shpërndajnë rezultatet e hulumtimeve/kërkimeve të tyre, për t'i vënë në dispozicion të kolegëve të tyre, hulumtuesve të tjerë, komunitetit akademik dhe arsimit, madje edhe më gjerë. Por, ky proces përfshin edhe të drejtat e autorit, procesin e shqyrtimit të artikujve nga departamentet, kolegët, burimet ekonomike të universiteteve, modelin e reja të publikimit (si qasja e hapur, open access) dhe depot institucionale), të drejtën për qasje në projektet e financuara nga qeveria, si dhe ruajtjen e asetëve intelektuale.

## PUNA KËRKIMORE DHE BIBLIOMETRIA

Puna kërkimore konkretizohet me botimet shkencore të botuara dhe në cilat revista prestigjioze janë botuar. Por, për të matur këto output-e hyn në lojë bibliometria. Bibliometria në ditët e sotme, po merr një rëndësi gjithmonë e më të madhe dhe kjo falë zhvillimit të teknologjive moderne të informacionit si edhe politikave gjithmonë e më angazhuese për kërkimin shkencor. Duke qenë se është një metodë sasore dhe cilësore, që mbështetet në përlogaritjen e botimeve si dhe të elementeve të nxjerra nga bibliografitë, bibliometria bëhet jo vetëm garante e rezultateve objektive të këtyre përlogaritjeve, por sidomos një mjet shumë i efektshëm për vlerësimin e kërkimit shkencor, pasi qëllimi kryesor i saj është të "gjurmtojë" sasinë dhe cilësinë e botimeve të autorëve të ndryshëm në një fushë të caktuar të kërkimit shkencor. Duhet theksuar se bibliometria ia detyron rëndësinë e saj sidomos analizës së citimeve, i cili është një mjet që rendit të gjitha referimet bibliografike që gjenden në një trup dokumentesh të përzgjedhur duke lidhur çdo botim me citimet që i janë bërë atij botimi.

Treguesi më i njohur bibliometrik është Impakti Faktori, (IF), i cili jepet nga raporti midis numrit të citimeve të marra gjatë një viti të caktuar nga një artikull i botuar nga revistat gjatë dy viteve të fundit, si edhe nga totali i artikujve të botuar në revistë gjatë dy viteve të fundit të marra në analizë.

Vlerësimi i botimeve shkencore është një strategji që qeveritë dhe universitetet vendode të ndryshme në botë e përdorin jo vetëm për të matur vlerat dhe meritat akademike të docentëve apo punonjësve shkencorë, por sidomos në ndarjen e fondeve të përcaktuara për kërkimin shkencor. Domosdoshmëria për të matur veprimtarinë shkencore të një institucioni, duke përllogaritur punimet shkencore të botuara, solli detyrimisht edhe lindjen e treguesve për revistat që botojnë këto punime shkencore. Përkishtë këta tregues përdoren nga bibliometria (aspak ose fare pak e njohur në Shqipëri), për të vlerësuar nga ana sasore dhe me anë të modeleve matematikore dhe statistikore, prodhimtarinë e dokumenteve, përdorimin e tyre, peshën ose faktorin e impaktit në shoqëri dhe në komunitetin shkencor.

## KRITERET E VLERËSIMIT SHKENCOR TË UNIVERSITETEVE

Çfarë kritere duhet të përdorin Universitetet për vlerësimin e kërkimit shkencor e konkretizuar kjo në botime, artikuj shkencorë, dizertacione etj?

Ai më kryesor është origjinaliteti, risija, metodologjia dhe rëndësia që këto botime i sjellin komunitetit shkencor dhe vendit përkatës, por të gjitha këto së bashku lidhen edhe me faktin se sa ndikim kanë këto botime në komunitetin shkencor vendas dhe ndërkombëtar. Për të vlerësuar impaktin në komunitetin ndërkombëtar hyn në lojë banka e të dhënave bibliografike botërisht të njohura si Web of Science, Scopus, ISI, Hirsch index.

Në vendin tonë së pari duhet të jenë bibliotekat universitare ato duhet të krijojnë bazën e të dhënave të botimeve të profesorit.

Bibliometria lindi si një metodë efiçase për të vlerësuar universitetet dhe fushat e kërkimit, por edhe për bibliotekat universitare, të cilat janë pjesë thelbësore e universiteteve. Për këtë arsye sot në botë bibliometria përkufizohet si një metodë kërkimi në fushën e shkencës së informacionit dhe bibliotekave, (në vendin tonë vazhdon të quhet bibliotekëkonomi), pasi të dhënat që nxirren nga analiza bibliometrike lidhen në procesin zinxhir me politikën e përzgjedhjes, blerjes, qasjes dhe përdorimit të koleksioneve bibliografike, si edhe për heqjen e asaj literature që nuk përdoret më, për arsye të ndryshme. Bibliometria si qëllim kryesor ka analizimin e koleksioneve bibliografike dhe të shërbimeve bibliografike për të nxjerrë lidhjen sasore midis dokumenteve dhe elementeve që i përbëjnë (fjalët, citimet, autorët, institucionet, etj), e lidhur ngushtë kjo me disiplinat përkatëse.

Në studimin tim me temë: "Krahasoni i botimeve shkencore në universitetet teknike publike dhe private në Shqipëri", duke përdorur metodën bibliometrike, u

analizuan artikujt shkencorë të botuar nga Universiteti Politeknik i Tiranës dhe tre universitete private të të njëjtit profil, nga viti 2008-2013. Të dhënat u morën nga Web of Science (Thomson Reuters), <http://isiknowledge.com>.

U analizuan artikujt shkencorë në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze, të botuara këto të fundit në revista të ndryshme shkencore, të huaja, në bazë departamentesh, fakultetesh, artikujt me një, dy, tre dhe me më shumë autorë, si edhe revistat ku janë botuar.

Rezultatet: Nga vitet 2008-2013 Universiteti Politeknik kishte 55 artikuj në gjuhën shqipe dhe me abstrakt në anglisht, nga të cilët vetëm 10 prej tyre me një autor, pjesa tjetër janë me tre ose 4 autorë. Fakultetet më prodhimtare Inxhinieria e Teknologjisë së Informacionit dhe Inxhinieria Elektrike, me nga 15 artikuj secila. Përsa i takon departamenteve, ai i elektronikës dhe telekomunikacionit si dhe ai i sistemeve elektrike të fuqisë. Ajo që bie në sy është numri i artikujve të botuar në revistat e huaja, 120, nga të cilët vetëm 6 me një autor, të tjerët janë me më shumë se gjashtë autorë. Mungesa e fondeve, i ka detyruar profesorët të gjejnë vetë financime dhe bashkëpunime sidomos me profesorë të huaj, gjë që ul edhe kostot e botimeve.

Nga studimi ka dalë, se në artikujt me bashkëautorë shumica e tyre janë të huaj. Studimi tregon se 96,5% e artikujve realizohen me bashkëautorë të huaj, vetëm 3,5% realizohet me financimin e vetë profesorëve. Pozitive është bashkëpunimi ndërkombëtar, sepse natyra e universiteteve është edhe ndërkombëtarizimi, pasi universitetet prodhojnë njohuri dhe njohuritë janë globale. Adams<sup>1</sup> thotë se procesi ndërkombëtar i hulumtimit është në rritje në të gjitha vendet. Pečlin<sup>2</sup>, thotë se shkencëtarët e vendeve periferike janë të gatshëm të bashkëpunojnë që të kenë qasje në burime. Ndërsa Juznić<sup>3</sup>, shpreh se gjatë njëzetë e pesë viteve të fundit, bashkëpunimi ndërkombëtar si pjesë e output-eve të hulumtimeve globale është trefishuar, duke u bërë gjithmonë e më i rëndësishëm.

Pra, për ato burime që nuk ofrohen nga universitetet, deleguar kjo fakulteteve përkatëse, profesorët shqiptarë gjejnë burime alternative, si për të dhënë informacion mbi punën e tyre shkencore, ashtu edhe për të thithur risitë në shkencë. Përsa i takon citimeve të artikujve shkencorë të botuar nga profesorët e UPT, për periudhën e lartpërmendur, treguesi është zero. Përsa i takon revistave ku janë botuar, vetëm 2% e tyre bën pjesë në elitën e revistave shkencore.

## KUR DUAM TË VLERËSOJMË UNIVERSITETET...

Duhet vlerësuar maksimalisht angazhimi i qeverisë aktuale dhe ministrisë së linjës për vlerësimin e universiteteve publike dhe private. Por kriteret e këtij vlerësimi nuk kanë qënë tërësisht shkencore

Duhet vlerësuar maksimalisht angazhimi i qeverisë aktuale dhe ministrisë së linjës për vlerësimin e universiteteve publike dhe private. Por kriteret e këtij vlerësimi nuk kanë qënë tërësisht shkencore. Edhe studues të tjerë kanë vërejtur se "procesi i akreditimit, me gjithë rëndësinë e vet, nuk mjafton, sepse ai grupon universitetet në brenda apo jashtë standardit, por nuk i rendit (klasifikon) ato nga pikëpamja cilësore".



Dua të nënvizoj se renditja e universiteteve me metoda bibliometrike është një instrument i rëndësishëm për vlerësimin e nivelit të performancës së tyre. Këtu, elementët bibliometrikë, të tilla si numri i publikimeve dhe citimeve të këtyre publikimeve, luan rolin kryesor. Ky klasifikim sugjeron një thjeshtësi për vlerësimin e performancës mësimdhënëse e shkencore. Sikurse e kam përmendur më lart, ai bazohet në analizën statistikore të përdorimit të dokumenteve (download, leximin online), nëpërmjet monitorimit të logfiles-ve që gjenerohen nga web server-at.

Për hir të së vërtetës duhet thënë se ka pasur një nisim nga MASH për të bërë një lojë "ranking" të universiteteve me kompani të huaj, por ende e pa materializuar.

Mjaft diskutime e debate zhvillohen në botë në aspektin e përzgjedhjes së metodës së vlerësimit me "peer review" apo "tregues bibliometrikë". Edhe në Shqipëri ka filluar të flitet për këto metoda. Do mendoja se për një përmirësim substancial të vendim-marrjes në mësimdhënie e kërkim, procedurat e vlerësimit me "peer review" duhet të përdoren paralelisht me treguesit e avancuar bibliometrikë. Mendimi i specialistëve është unik: Kombinimi i kërkimit operacional me teknikën e sofistikuar bibliometrike, do të ofronin shpresa për sisteme vlerësimi të pa kontestueshme.

Sipas mendimit tim, procedura me "peer review" duhet të mbetet procesi i parë i vlerësimit të kërkimit, ndërsa treguesit bibliometrikë duhet të veprojnë si instrumente mbështetës për ta bërë më objektiv dhe transparent procesin.

Renditja krijon mundësi për analiza krahasuese ndërmjet universiteteve, fakulteteve, departamenteve dhe bën të matshëm progresin e tyre, në raport me universitetet kombëtare dhe ato ndërkombëtare, duke nxitur cilësinë.

Nga ana tjetër, vlerësimi i treguesve bibliometrikë (citimi nëpërmjet klikimeve) në procesin e klasifikimit të universiteteve do të kërkonte ngritjen e një sistemi, i cili do të bënte mundur shkëmbimin e informacionit e njohurive shkencore online. Kjo do të bënte domosdoshmërisht eficient publikimin online (eLibrary) për transferimin e njohurive e të informacionit shkencor, duke mundësuar dhe lidhjen me sistemet e tjera ndërkombëtare. Kjo ndërmarrje do të nxiste citimet e literaturës shqiptare edhe nga studues ndërkombëtarë.

\*J) Doktorante, Instituti i Shkencave të Informacionit  
Universiteti i Ljublljanës, Slloveni

1)Dr Jonathan Adams, Drejtor i Vlerësimit Shkencor për Thomson Reuters.

2)PhD. Stojan Pečlin, Hulumtues në Agjensinë Sllovene të Kërkimit.

3)PhD. Primož Juznić, Shef i Departamentit të Informacionit dhe Shkencës në Fakultetin e Arteve, Universiteti i Ljublljanës.

# » ARTE PAMORE


**EKSPOZITA** është çelur mbrëmë në ambientet e galerisë “Vernissage” në Bulevardin Haussmann në Paris dhe do të qëndrojë e hapur deri në datën 24 dhjetor

## Kryeministri Edi Rama surprizon me ekspozitë në Paris

Ekspozita u çel mbrëmë bashkë me artistin shqiptar Bujar Luca. Rama ka ekspozuar ciklin e pikturave që e titullon “Letra zyre”

**XHULIA KARAVELLO**  
TIRANE


**K**ryeministri Rama i është rikthyer pasionit të tij të vjetër, pikturës, të cilën duket se nuk e ka braktisur edhe gjatë detyrës si kryeministër i vendit. Rama ka zgjedhur Francën ku ka jetuar gjatë viteve 1994-1997, për të ekspozuar disa nga punët e tij më të fundit në një ekspozitë të përbashkët me piktorin shqiptar Bujar Luca. “Letra zyre” titullohet cikli i ekspozuar, ku përfshihen disa nga letrat e tij zyrtare mbi të cilat ai ka pikturuar duke i shndërruar në vepra arti. Ekspozita është çelur mbrëmë në ambientet e galerisë “Vernissage” në Bulevardin Haussmann në Paris dhe do të qëndrojë e hapur deri në datën 24 dhjetor. Duket se pasioni i piktorit për kryeministrin shqiptar Edi Rama do të mbetet nga koha në kohë burim surprizash. Rama është i angazhuar, jo vetëm në performancat e këtij cikli ku ka shprehur pasionin në letra zyrtare gjatë punës së tij në detyrën e kryetarit të bashkisë së Tiranës apo të kryeministrit, por ai ka lënë gjurmë si piktor edhe në koleksionet e veprave kombëtare të artit. Një pikturë murale e muzeut të Lushnjës është bërë nga dora e kryeministrit shqiptar, së bashku me piktorin Lad Myrtezai. Piktori dhe kritiku Ilir Çakalli e ka përshkruar në një shkrim për “Shqiptarja.com” me këto fjalë: pikturën murale të Edi Ramës në Lushnjë: “Vepra thyente të gjitha kanonet e artit të Realizmit Socialist. Me një shtrirje mbi 15 m gjatësi dhe rreth 3.5 m lartësi lindte në atë mur një vepër, e cila do të sillte frymën e re të artit modern. Mund të thuhet që dhe artistët të tjerë ishin shprehur, por të ekspozojë një vepër të tillë madhështore, e kontestuar shumë nga politika e kohës, kërkonte një kurajë të madhe”. Ndërkohë një tjetër vepër të veçantë ruan edhe Galeria Kombëtare e Arteve e cila ruan në fondin e saj një pikturë të zgjedhur të kryeministrit, ku ai ka shprehur ndjeshmërinë e tij për çështjen kosovare. Piktura e bërë para viteve ’90 është trajtuar me elementë kubistë dhe i dedikohet heroit kombëtar Azen Galicës e mban titullin “Varrimi i Azem Galicës”. Kjo pikturë gjendet në fondin e Galerisë Kombëtare të Arteve në sallën e realizmit socialist. Ndërsa për sa i përket surprizës më të fundit si piktor, ka qenë vetë Rama i cili ka bërë të ditur për të gjithë shqiptarët që jetojnë në Francë këtë ekspozitë duke i ftuar ta vizitojnë. “Sot në Paris çelët kjo ekspozitë. Nuk është kohë e humbur për kë jetojnë apo kalon andej dhe merr mundimin ta shohë”, -ka shkruar Kryeministri në faqen e tij zyrtare në Facebook. Së bashku me Ramën në këtë ekspozitë do të shfaqen edhe punimet e piktorit Bujar Luca, i cili prej vitit 1990 jeton dhe punon në Francë. Bujar Luca është tashmë një emër i njohur në botën e artit. Ai ka marrë pjesë në ekspozita të tjera edhe në Britani të Madhe, Belgjikë, por edhe në vendin tonë. Kjo ekspozitë e Bujar Lucës së bashku me kryeministrin e Shqipërisë Edi Rama, ka ardhur në kujdesin e veçantë të ambasadës shqiptare në Francë. **Dhu.Ha.**




● **NË FOTO:** Posteri i ekspozitës që u çel mbrëmë në Paris



Kryeministri Edi Rama në një nga çastet që ushtron pasionin e pikturës



Një nga pikturat e Bujar Lucës në ekspozitën e përbashkët me Ramën në Paris



Një nga pikturat e ekspozitës së Edi Ramës në Paris

● **Facebook**  
Ka qenë vetë Rama i cili ka bërë të ditur për të gjithë shqiptarët që jetojnë në Francë këtë ekspozitë duke i ftuar ta vizitojnë. “Sot në Paris çelët kjo ekspozitë. Nuk është kohë e humbur për kë jetojnë apo kalon andej dhe merr mundimin ta shohë”, -ka shkruar Kryeministri në faqen e tij zyrtare në Facebook

## » EKSPOZITA

**NË DITËN** e trembëdhjetë të çeljes së Bunk'Art nuk ka reshtur ende fluksi e madh i vizitorëve. Pamje nga vërshimi i vizitorëve në ditën e djeshme



**DHURATA HAMZAI**  
TIRANE

**F**luksi i vizitorëve në Bunk'Art në ditën e trembëdhjetë të çeljes së tij nuk ka reshtur fluksin e madh të vizitorëve. Në këto foto që janë marrë ditën e djeshme duket interesi i lartë i vizitorëve të çdo moshe. Ekspozitat e shumta, por edhe reliket e periudhës së komunizmit të vendosura në bunkerin e nëndheshëm "Bunk'Art" vijnë të jenë ende më të vizituara nga qytetarët e shumtë. Përveç dhomave të udhëheqësve politikë të asaj kohe, si dhoma ku duhej të strehohej Enver Hoxha apo Mehmet Shehu në rastin e një sulmi antibërthamor, me mjaft kureshtje janë parë edhe objekte të ndryshme që përdoren rëndom në kohën e diktaturës e ruhen deri në ditët tona, si gotat, kolltukët, mobiliet, jorganët prej pambuku e atlasit të dizenuar me qepje me dorë, etj. Një nga 106 dhomat më të vizituara është edhe "Muzeumi i Ndërlidhjes". Kjo hapësirë i është dedikuar pikërisht komunikimit gjatë asaj periudhe ku aparaturat janë mjaft të përparuara për kohën.

Një slogan i regjimit komunist, por që edhe sot e kësaj dite, përdoret nga të gjithë ushtritë e botës është: "Pa ndërlidhje, nuk ka komandë dhe pa komandë, nuk ka fitore". Një pjesë e bunkerit, që për arsye sekreti, edhe sot është e ndarë nga pjesa tjetër e tunelit, ishte e destinuar për impiantin e ndërlidhjes. Në këtë dhomë janë ekspozuar disa nga aparatet origjinale të përdorura në vite nga ushtria shqiptare. Ato që duken më moderne ishin instaluar në repartin e ndërlidhjes së këtij bunkerit të inauguruar nga Enver Hoxha me 28 qershor të 1968. Përpos veçantisë së kësaj dhome në korridorët jashtë saj ekspozohet një foto e ish-diktatorit Enver Hoxha, i cili foton e ka realizuar pikërisht në vendin ku është vendosur. Që prej datës 22 nëntor, kur është çelur Bunk'Art, edhe ekspozita e 70-vjetorit të Çlirimit vijon të jetë mjaft e vizituar. Ajo "studiohet" me vëmendje nga një fluksi i lartë qytetarësh të të gjitha moshave, të cilët duket qartë se duan të njihen me ngjarje të panjohura të historisë së vendit tonë. Dokumentet origjinale të kësaj ekspozite janë zbuluar në Arkivin Qendror të Shtetit dhe në institucione të tjera drejtuese të vendit. Ekspozimi i tyre është kuruar nga historiania Sonila Boçi dhe gazetarja Admirina Peçi. Bunkerit i nëndheshëm 5-katësh u ka ofruar dje kënaqësi edhe të apasionuarëve pas instalacioneve artistike. Vizitorët të rinj e të moshuar, ndërkohë që preferojnë të shohin me vëmendje dokumente historike origjinale dhe objekte muzeale që tregojnë rreth periudhës së komunizmit.

### DHOMA "PROPAGANDË DHE DHUNË"

Një hapësirë e veçantë për të treguar ndikimin e propagandës me anë të medias

# Bunk'Art, shtohet kureshtja për reliket e diktaturës

Që prej 22 nëntorit, kur është çelur Bunk'Art, edhe ekspozita e 70-vjetorit të Çlirimit vijon të jetë mjaft e vizituar



në periudhën e komunizmit i është dedikuar në bunkerin e nëndheshëm të komunizmit. "Propagandë dhe dhunë" është një nga 106 dhomat e Bunk'Art që tregojnë anën më të errët të historisë së popullit shqiptar. Për orë të tëra në ekranin e vetëm të asaj kohe RTSH, shfaqeshin reportazhe ku i thurnin elozhe partisë komuniste dhe arritjeve të saj

jo të vërteta. Bunkerit i nëndheshëm 5-katësh i kohës së komunizmit i pagëzuar me emrin "Bunk'Art, është një dëshmi për të risjellë në vëmendje një nga kohët më të errëta që kanë kaluar shqiptarët. I mbyllur prej 36 vitesh ky bunker tashmë është kthyer në një nga vendet më të vizituara që prej datës 22 nëntor kur është hapur për publikun.

### Fotot

Në këto foto që janë marrë ditën e djeshme duket interesi i lartë i vizitorëve të çdo moshe. Ekspozitat e shumta, por edhe reliket e periudhës së komunizmit të vendosura në bunkerin e nëndheshëm "Bunk'Art" vijnë të jenë ende më të vizituara nga qytetarët e shumtë.

### Interesimi

Që prej datës 22 nëntor, kur është çelur Bunk'Art, edhe ekspozita e 70-vjetorit të Çlirimit vijon të jetë mjaft e vizituar. Ajo "studiohet" me vëmendje nga një fluksi i lartë qytetarësh të të gjitha moshave, të cilët duket qartë se duan të njihen me ngjarje të panjohura të historisë së vendit tonë

### Teatri "Spahivogli"

## Komedi për fëmijë "Grinç vjedh Krishtlindjet"

— "Grinç vjedh Krishtlindjet" është pjesa frymëzuar nga tregimi i Dr. Seuss shkruar që në vitin 1957, e cila do të shfaqet premierë këtë fundjavë (të shtunën dhe të dielën ora 10:30) në Teatrin Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli". Regjisori Endri Çela, në skenografinë e Beqo Nanaj, kostumografinë e Sofi Kara, koreografinë e Aledia Kondaj dhe as.regjisoren Madi Selimi dhe një ekip skenografësh, kostumografësh, koreografësh, kompozitorësh, etj,

sjellin në skenën e TKEKS një shfaqje gazmore për fëmijë. Aktorët interpretues Erdit Asllani, Edvin Mustafa, Adriana Tolka, Klea Zeka, Oriana Cama, Fatjon Mici, Sara Jaupaj, Klodjana Keço, Elidon Alike, Aldjon Matarangasi dhe Anderson Gurra premtojnë një komedi profesionale për Krishtlindjet. Komedia është konceptuar në formën e një muzikali ku aktrimi shkrihet shumë bukur me këngën dhe performancë koreografike, bën me dije TKE.



● **Premiera**  
Shfaqet këtë fundjavë (të shtunën dhe të dielën ora 10:30) në Teatrin Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli"



NGA ARBEN DUKA

## SATIRË POLITIKE

# Homoseksualiteti nuk është absolutisht një vlerë e shtuar..

Në vatanin tonë të dashur,  
kurrë nuk mbaron çudia,  
një ligj për martesat "gay",  
po përgatit qeveria!

Po në fakt ne s'kemi parë,  
këtu homoseksualë,  
se këtu shumicë e tyre,  
janë ende ilegalë!

Që t'i biem drejt e drejt,  
e aspak anës e anës,  
s'quhen homoseksualë,  
ata të Urës së Lanës!..

Ata kërkojnë nga ne,  
ca qëndrime më të buta,  
ndërsa vetë akoma rrinë,  
rrinë fshehur nëpër skuta!

Jo më shumë se një duzinë,  
nga ata ne kemi parë,  
dhe s'e dimë në fenomenin,  
është dhe fenomen shqiptar?!

Ata kërkojnë me ngulm,  
që nga neve të pranohen,  
kur shumica rrinë në skuta,  
dhe për ne s'dekonstruohen!

Mos duash sojin e tyre,  
s'është thjesht një punë inati,  
edhe mund t'i integrojmë,  
por ende ata s'janë gati!

S'i kemi parë të shpalosur,  
kjo tregon se s'janë gati,  
kemi parë që t'i mbrojnë,  
një si punë avokati!

Ai flet në vetë të tretë,  
ndaj pyes me këtë rast,  
nëse avokati vetë,  
është a s'është një pederast?!

Është dhe një vajzë që flet,  
dhe në fakt është shumë neurike,  
po ajo në të vërtetë,  
s'na ka thënë që është lesbike!

Gjithë problemin ne e njohim,  
se mbase në planin teorik,  
ata s'dalin se dhe vetë,  
kanë turp e kanë frikë!

Ata rrinë ilegalë,  
se mbase e kanë kuptuar,  
se sektin homoseksual,  
është vështirë për t'u pranuar!

S'di pse nxiton qeveria,  
që ata të ligjërohen,  
se dhe ligji po të dalë,  
ata prapë nuk do martohen!

Janë dylberët e dylberet,  
nga turku të trashëguar,  
po shteti turk asnjëherë,  
ata nuk i ka pranuar!

Si Spahia i zogistëve,  
unë s'jam partizan i hurit,  
por më duket neveri,  
që t'ja hipi burri burrit!

Ata që votojnë ligjet,  
duhet mirë që ta peshojnë,  
se homot do kenë të drejtë,  
dhe fëmijë të adoptojnë!

Unë jam i civilizuar,  
po kam thënë dhe tjetër herë,  
nuk e shoh pederastinë,  
absolutisht si një vlerë!

Mes tyre të bëjnë ç'të duan,  
si të duan të p...n,  
po shoqërisë së shëndoshë,  
s'mund e s'mund t'i imponohen!

Tani s'i fut kush në burg,  
dhe nuk po diskriminohen,  
po është shpejt e shumë shpejt,  
me martesë të ligjërohen!

Dhe sot s'i ndalon askush,  
ata që të bashkëtojnë,  
po devijimin e tyre,  
nuk mund të na imponojnë!

Të bëjnë ata që bëjnë,  
është në të tyren dëshirë,  
por shumica e shqiptarëve,  
nuk i sheh me sy të mirë!

S'ka pse çdo pisllek i Botës,  
të vijë dhe në Shqipëri,  
për homot-me hakë të Zotit,  
unë ndjej vetëm neveri!

Sot me ligj akti i tyre,  
nuk dënohet-s'quhet faj,  
ky është një hap përpara,  
hapi tjetër më pastaj!

Perëndimi-ku po vemi,  
mendton se shikon më gjerë,  
po homoseksualiteti,  
është dhe mbetet antivlerë!

## Urim

## PËR DITËLINDJEN E MBESËS SIME TË SHTRËNJTË, SOFIA ELENA DUKA..

(NË TENNESSEE, SHBA)

Përpara dy vjetësh,  
ndodhi mrekullia,  
se erdhi tek ne,  
si ëngjëll Sofia!

Se erdhi Sofia,  
si Ëngjëll i Zotit,  
e bukur-e bukur,  
si pika e lotit!

Si pikëz e lotit,  
si lule-si flutur,  
ndaj e gjithë Bota,  
u bë më e bukur!

U bë më e bukur,  
u bë më e mirë,  
sepse erdhe Ti,  
dritë e ëmbëlsirë!

Ti je sot akoma,  
zog me cicërimë,  
ne gjuhën e zogjve,  
veç nga ty e dimë!

Ti na e mësove,  
Sofi dallandyshta,  
po të kanë shumë larg,  
gjyshi edhe gjyshja!

Por çdo çast të ditës,  
je me ne-o xhan,  
s'pyet dashuria,  
për një oqean!

Për një oqean,  
as për dy e tri,  
se porteti yt,  
na u gdhënd në sy!

Ti na ndrin në sy,  
si dritë e pasosur,  
bukuria jote,  
lindi e vulosur!

Ti je më e ëmbël,  
dhe nga mjalti i bletës,  
tek Ty rjedh e rjedh,  
burimi i jetës!

Je pasqyra jonë,  
e ëmbla Sofi,  
ndaj dhe ne të duam,  
në pafundësi!

Sot je kryekënga,  
plot me melodi,  
ndaj të nisëm sot,  
këtë poezi!

Po ti qumështore,  
sot s'mund ta kuptosh,  
as urimin tonë:  
"Njëqind vjet të rrosh!"

Përveç poezisë,  
s'kam tjetër peshqesh,  
po ti vargje do,  
se je një Dukëshë!

Pranë e pranë ditlindjet,  
na bëre-o Zot,  
mbesa e kish dje,  
Gjyshi e ka sot!

# ISH-MISSI Agnesa Vuthaj fut kontrabandë në doganë, gjobitet

Ish-Miss Kosova, kapet nga Dogana e Kosovës duke futur kontrabandë 11 fustane

Ish-missi i Kosovës, Agnesa Vuthaj është kapur nga Dogana e Kosovës duke futur kontrabandë, 11 fustanë. Ky lajm është konfirmuar nga zëdhënësi i Doganës, Adriatik Stavileci.

Bukurshja e cila ka mbajtur kurorën e 'Miss Kosovës', është themeluese dhe drejtuese e bizneseve "Agnesa Vuthaj Fashion" dhe "Agnesa Vuthaj Association". Sipas mediave kosovare, Agnesa është kapur në

doganën e aeroportit me një ngarkesë prej 11 fustanesh, të cilat kapin një shifër mbi 500 euro, të cilat nuk ishin të deklaruar. "Është e vërtetë se zonja Vuthaj me datën 22.05.2014, rreth orës 20:30h në hyrje të pikës së kalimit kufitar, aeroport, gjatë kontrollit doganor nuk ka deklaruar mallin: fustanë të ndryshëm solemn, në sasi prej 11 copë, në vlerë prej 560.00€. Pra, me këtë veprim ka tentuar t'i shmangte detyrimin ligjor për pagimin e

taksave importuese doganore e me këtë rast ka kryer kundërvajtje doganore nga neni 250 pika 3 të Kodit Doganor dhe të Akcizave. Ndaj Komisioni për kundërvajtje doganore e dënoi me gjobë në të holla në shumën prej 154.00". Edhe pse Agnesa nuk ka dhënë ndonjë reagim lidhur me këtë akuzë të bërë, burimet pranë zëdhënësit të doganës thonë se ajo e ka shlyer gjobën, por malli i është konfiskuar.



## Agron Llakaj Rrëfen arratisjen në Greqi, imitova Berishën

— Sali Berishën e kam imituar për herë të parë në vitin 1994. Ai atëherë ishte president dhe kjo pati efektin e një Boom-i. Unë shquhem se jam trim, por pas kësaj i'a mbatha për 4 muaj në Greqi". Kështu ka deklaruar Agron Llakaj, aktor dhe prezantues i programit televiziv "Al Pazar" në Vizion Plus, i cili ka qenë i ftuar në një emision të njohur "The Karntasians" në Greqi të televizionit Antena 1. Përpos kësaj, Llakaj i cili gjatë gjithë emisionit ka folur shqip, ka interpretuar një skeç në greqisht ku ai parodizonte trysinë e grekëve që emigrantët shqipëtarë të ndërrojnë emrat. Ai ka rrëfyer me këtë fabul një histori nga e shkuara e të atit të tij. Videoja e tij në këtë emision është kthyer në hit në internet, sidomos mes emigrantëve në Greqi.



## Modelja Angela Martini sfidon të ftohtin në dhjetor

— Modelja e njohur shkodrane, Angela Martini ka rritur sërish temperaturat në rrjetet sociale. "Ëatch my back" (Shihni shpinën time), ka shkruar ajo përbri fotografisë në "Instagram", ku shfaqet vetëm me mbathje, por me shpinë të kthyer. Kujtojmë se, modelja prej kohësh po prek suksesin edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, gjithmonë e ndjekur nga fotografët më të mirë.



### Kalendari Kulturor

#### GALERIA "FAB", UNIVERSITETI I ARTEVE

- "Udhët" është kthyer tashmë në traditë çdo muaj nëntor. Kjo ekspozitë nuk është një ekspozitë e zakonshme dhe për ata që duan të shijojnë vetëm gjiminë e një tabloje klasike, këtu prezantohen edhe vepra të tjera të artit bashkëkohor ku nuk mungojnë dhe skulpturat. Kryesisht me punime të viteve të fundit pjesëmarrës në ekspozitën "Udhët 4" të kuruar nga Emri Hoxha do të jenë pedagogët e artit : Arben Bajo, Ardian Isufi, Albes Fusha, Ardian Kapo, Edison Çeraç, Ergys Krisiko, Ervin Bëxolli, Ermal Baboçi, Emanuel (Sali) Koko, Florian Haxhijenshi, Fatmir Miziri, Harri Aleksi, Gazmend Leka, Genc Mulliqi, Genc Përmeti, Ilir Kaso, Klod Agostini, Oris Vathi, Matilda Odobashi, Mikel Temo, Najada Hamza, Shpëtim Kërçova, Viktor Ferraj, Vladimir Myrtezai, Vladimir Llakaj. Kjo ekspozitë do të qëndrojë e hapur deri më 5 dhjetor vjen për të katërtin vit rradhazi.



#### PROGRAMI I FILMAVE NE RRJETIN IMPERIAL PER DT 29.11.2014- 03.12.2014

##### SALLA 1

- "Horrible Bosses 2 " 2D/ 15:30 / 20:30 / Çmimi 500 Leke
- "Penguins Of Madagascar" 3D/ 10:30 / 17:30 / Çmimi 500 Leke
- "The Hunger Games:Mockingjay " 2D/ 13:00 / Çmimi 500 Leke
- "Dumb And Dumber 2 " 2D/ 22:15 / Çmimi 500 Leke

##### SALLA 2

- "Horrible Bosses 2 " 2D/ 13:00 / 19:00 / Çmimi 500 Leke
- "The Hunger Games:Mockingjay " 2D/ 11:00 / 17:00 / Çmimi 500 Leke
- "Dumb And Dumber 2 " 2D/ 15:00 / Çmimi 500 Leke
- "Laggies " 2D/ 21:00 / Çmimi 500 Leke

#### KINEMA AGIMI

- "Horrible Bosses 2 " 2D/ 20:00 / 22:00 / Çmimi 500 Leke
- "Penguins Of Madagascar" 3D/ 10:00 / 15:00 / Çmimi 500 Leke
- "The Hunger Games:Mockingjay " 2D/ 12:30 / 17:30 / Çmimi 500 Leke

#### PREMIERE BOTORE D.T. 04.12.2014

- 1- When The game Stands Tall 2D
- 2- John Wick 2D
- 3- Diptik 2D

# Kthehen 3 muskëtierët e kuq, Erando Karabeci “harron” Partizanin

Nexhipi, Mazrekaj dhe Racic janë vendosur nën urdhrat e trajnerit Shpëtim Duro



**Derbi**  
DYLBER BALLA  
TIRANË

Endërsa FSHF ka ndezur dritën jeshile për praninë e tifozëve të Tiranës në stadium për ndeshjen derbi përballë Partizanit, bardheblutë janë mobilizuar akoma më shumë për fitoren. Një nga futbollistët kryesorë të Tiranës, Erando Karabeci shpreh optimizëm për fitoren në derbin e dytë të këtij edicioni përballë ish-të kaluarës së tij. Fakti që ka dalë nga akademia e ekipit të Partizanit nuk e pengon lojtarin që të

nxjerrë dëshirën për fanellën në bazë të bilancit për vitet që ka mbi supë me secilin ekip. “Kam luajtur 2 vjet te skuadra e parë e Partizanit dhe u jam mirënjohës trajnerëve me të cilët kam punuar, që më ka dhënë dorë duke më aktivizuar në formacion, por unë kam më shumë vite si bardheblu. Ata tifozë të Partizanit që më shajnë, kur unë vishja fanellën e kuqe nuk ekzistonin fare” shprehet mesfushori i ekipit të 24 herë kampionëve. Më pas Karabeci ndalet te sfida duke analizuar formacionet e dy ekipeve dhe mundësitë. “Partizani ka një mbrojtje solide, por unë jam i bindur se me grindën që na karakterizon do të fitojmë. Mund të në penalizoj terreni i vështirë, që ndoshta s’do të na lejojë të dalim në lojën tonë. Por unë kam besim

të plotë se ekipi do të japë maksimumin për të marrë fitoren në derbi” tha ai. Përsa i përket vendimit për lejimin e tifozëve në stadium, edhe pse u thye rregullorja, Karabeci nuk ka si të ndodhë ndryshe, por mbështet vendimin. “Derbi me tifozë të dy ekipeve është lajmi i bukur. Janë ti-

**PARTIZANI I PLOTË**

Partizani ia ka dalë mbanë që të rikuperojë për ndeshjen derbi me Tiranën Nderim Nexhipin dhe Mentor Mazrekajn, teksa rikthehet në repartine sulmit edhe serbi Racic. 3 lojtarët e cilësuar nga trajneri Duro si, 3 muskëtierët janë vendimtarë për Partizanin, që është në kulmin e rezultateve

**KARABECI**

“Ata tifozë të Partizanit që më shajnë, kur unë vishja fanellën e kuqe nuk ekzistonin fare” deklaron mesfushori i ekipit të Tiranës, i dalë nga akademia e Partizanit.

fozët ata që me koreografinë e tyre e bëjnë edhe më të bukur derbin” përfundon ai.

muskëtierët janë vendimtarë për Partizanin, që është në kulmin e rezultateve

pozitive. Nderim Nexhipi dhe Mentor Mazrekaj janë rikthyer në stërvitje duke u vendosur në urdhrat e trajnerit Shpëtim Duro duke qenë pjesë e strategjisë për mposhtjen e bardhebluve dhe ndoshta një trampoline jashtë vendit duke qenë se ndeshja do të transmetohet nga Sky Sport në Itali për herë të parë. Ndeshja do të zhvillohet ditën e hënë në orën 18:00 në stadiumin kombëtar “Qemal Stafa”. Aktualisht Partizani komandon kampionatin, i ndjekur nga Tirana me një pikë më pak.

LAJME  
shkurt

**UEFA zyrtarizon Ligën e Kombeve starton në vitin 2018, ja skema**


UEFA zyrtarizoi formatin e ri “Uefa Liga e Kombeve”, e cila do luhet nga muaji shtator deri në nëntor të 2018. Liga e Kombeve do të përbëhet nga 4 divizione ku çdo division do të ndahet në 4 grupe me 3-4 skuadra. Liga A përfshin ekipet më të mira të kontinentit, ndërsa D ekipet më të dobëta. A dhe B do të përbëhen nga 4 grupe me nga 3 ekipe, ndërsa divizioni C, 3 grupe me nga 3 kombëtare dhe 2 grupe me nga 4 skuadra. Liga D me 4 grupe dhe 4 skuadra. Renditja në Ligën e Kombeve do të caktojë edhe kompozimin e vazove për fazën eliminatorë.

**Legjionarët**  
TIRANË

Shkëlzen Gashi është zgjedhur futbollisti më i mirë i vitit 2014 te Basel. Rreth 5000 lexues kanë marrë pjesë në anketë, duke e renditur sulmuesin kosovar në vendin e parë me 2803 vota. Edhe pse iu bashkua klubit vetëm gjatë verës nga Grasshoppersi dhe që ishte dikur i rivalit, Zurich, Gashi fitoi zemrat e tifozëve të Baselit, pasi realizoi 13 gola në 18 ndeshje në kampionatin zviceran. “Jam i kënaqur me zgjedhjen dhe më duhet t’i falënderoj. Jam integruar në ekip me lehtësi. Shpresoj që kështu të vazhdoj edhe në të ardhmen duke shënuar sa më shumë gola për të ndihmuar ekipin në kampionat, por edhe në Europë” tha Gashi. Sulmuesi është një nga lojtarët vendimtar në ekipin e tij në Zvicër, por në ekipin kombëtar të futbollit nuk po gjen hapësirë në formacionin e trajnerit De Biasi. Kubilay Tukllmaz, i cili ka luajtur 62 ndeshje për kombëtaren zvicerane, në një opinion shpreh se “Shkëlzen Gashi një fenomen”.

# Shkëlzen Gashi, më i miri i vitit Berisha drejt largimit nga Suedia

Sulmuesi kosovar u shpall më i miri i Grasshoppers në Zvicër



**Sulmuesi**  
Gashi realizoi 13 gola në 18 ndeshje në kampionatin zviceran. “Jam i kënaqur me zgjedhjen dhe më duhet t’i falënderoj. Jam integruar në ekip me lehtësi” deklaroi sulmuesi.

Kosovari është shprehur se nuk ka arritur marrëveshje me ndonjë klub dhe se është i hapur për çdo alternativë. “Jemi duke punuar intensivisht së bashku me menaxherin dhe shpresoj që së shpejti do ta bëjmë një zgjidhje sa më të mirë. Nuk e kam të caktuar ekipin e ri, mirëpo jemi të hapur për çdo alternativë”, tha Berisha. Lojtari kosovar është në qendër të disa ekipeve të tjera në kampionatin suedez të futbollit, por ende nuk ka asgjë konkrete. Nuk

**Kërcënimi**  
Ish-i i De Rossit: I jap 10 mijë € një shqiptari e të vras

Ish-bashkëshortja e lojtarit të Romës, Daniele De Rossi është në arrest shtëpie pasi akuzohet për pengmarrjen e një biznesmeni dhe torturimin e tij. Gjykatësi i cili po heton Tamara Pinsoli-n, thotë se ajo ka personalitet narcistojë dhe përpiqet të mbizotërojë dhe manipulojë të tjerët për interesat e saj. Ngjarja ka si shkak 85 mijë euro, të cilat Pinsoli ia ka dhënë biznesmenit për t’i investuar dhe më pas ka kërkuar që t’i kthejë 150 mijë euro, raporton “Il Messaggero”. Pasi biznesmeni ka refuzuar të kthejë paratë, Pinsoli e ka kërcënuar me këto fjalë: “Ti e di që të vras. Paga një shqiptari dhe të vret! Mjafton t’i jap 10 mijë euro!” Por, 31-vjeçarja në polici ka deklaruar se kjo ishte një batutë dhe provokim, dhe nuk ishte kërcënim për jetën.

**ILIR BERISHA NË MERKATO**  
Futbollisti i përfaqësueses së Kosovës, Ilir Berisha, është

në kërkim të skuadrës së tij të re, pasi i ka përfunduar kontratën me klubin suedez Orebro.

përjashtohet mundësia që lojtari të vazhdojë karrierën në kampionatin italian të futbol-

lit, pasi më parë është folur për trantativa të mundshme mes palëve për transferimin.

**Gjermania i thotë "PO" teknologjisë në vijën fatale të portës nga 2015**

Pas Anglisë edhe futbollit në Gjermani i ndez dritën jeshile përdorimit të teknologjisë në vijën e portës për të verifikuar nëse topi e ka kaluar vijën fatale ose jo. Duke nisur që nga sezoni i ardhshëm, falë marrëveshjes së arritur mes 18 klubeve gjermane, do të aplikohet teknologjia e linjës së portës që parashikon instalimin e 14 telekamerave, të cilat do të japin me saktësi 100 % verdiktin nëse topi e kalon ose jo vijën fatale në raste të veçana. Nëse goli është i rregullt, arbitrit do t’i shkojë automatikisht një sinjal në orë.

# PARADE FJALEKRYQESH

NGA KADRI VOKOPOLA



**VIDEO/**  
**ALEX CURRY,**  
**GAZETARJA**  
**ME SEKSI E**  
**AMERIKES**



Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të A1REPORT që shkarkohet falas

## HOROSKOPI

**Dashi**  
Sot do përjetoni shume çaste romantike pranë personit që dashuron dhe do doni që dita të mos ketë një fund. Edhe beqaret do kenë një ditë pozitive dhe plot takime miqësore. Shitfrytëzimi gjithësecilin deri në maksimum. Buxheti duhet të menaxhoni me sa me shume kujdes që të mundeni në mënyrë që të mos keni probleme as sot e as me vonë.

**Demi**  
Ndjenja të ndryshme do përzihen sot në jetën tuaj në çift dhe gjerat nuk do ecin ashtu si i kishit ëndëruar. Mos bëni gabim të tregoheni kokëfortë. Beqaret do vazhdojnë të jene në kërkim të shpirtit binjak, por fatkeqësisht pa fat. Në planin financiar do keni surpriza të njëpasnjëshme. Gjendja do jete tejet e qëndrueshme dhe do mund të kryeni investimet e dëshiruara.

**Binjakët**  
Partneri do ua shprehë pa pushim ndjenjat gjatë gjithë kësaj dite dhe do ndjeni për mrekulli në krahet e tij. Mbrëmja do jete me emocione dhe me ë këndshme. Beqaret do kenë mundësi për aventura pa fund, por asgjë më tepër sesa aq. Me financa mos u tregoni të pamatur sepse situata ka gjasa t'u përkeqësohet tej mase. Shpenzoni me kursim edhe për disa kohe.

**Gaforja**  
Klima yjore do favorizojë tej mase jetën tuaj në çift gjatë kësaj dite. Do merreni vesh për çdo gjë me partnerin tuaj dhe marrëdhënia me të do jete fantastike. Beqaret do realizojnë një takim, por fatkeqësisht nuk do e gjejnë dashurinë e madhe që kane pritur prej kohesh. Financat nuk do jene të këqija kështu që mund të përfitorni nga kjo për të kryer shpenzimet e menduara.

**Luani**  
Edhe pse rutina do mbizotërojë gjatë gjithë kohës në jetën tuaj në çift, duhet të nën se ajo do jete e ekuilibruar dhe jo problematike. Merrni gjerat si t'u vijnë. Beqaret duhet të njihen mire me personat që do takojnë para se të vendosin të hedhin hapa me tëj. Për sa iu përket financave, gjithçka do varet nga sjellja juaj. Po shpenzuar shuma marramendëse do keni vështirësi.

**Virgjëria**  
Ka shume mundësi që marrëdhënia juaj në çift të kalojë një fazë delikate sot. Mundohuni të hapni ruge dhe të toleroni sa me shume në mënyrë që gjerat të mos marrin kalapetë. Beqaret do dashurohen koke e këmbë pas një personi i cili prej shume kohesh i ka joshur me mënyrën e tij. Klima yjore për sektorin e financave do jete shume e turbullur gjatë gjithë kësaj dite. Kujdes!

**Peshorja**  
Marrëdhënia në çift do jete tejet e komplikuar gjatë kësaj dite. Do thurni shume gënjeshtra përkundrejt partnerit dhe kur ato të dalin në dritë nuk do dini si të shfajësoheni. Kujdes! Beqaret ka shume mundësi që në momentin që me pak e presin të takojnë shpirtin e tyre binjak. Në sektorin financiar do jete Neptuni ai që do iu ndihmojë t'i zgjidhni të gjitha problemet.

**Akrepi**  
Asgjë katastrofike nuk ka për të ndodhur sot në jetën tuaj sentimentale. Në orët e para të ditës do ketë disa debate, por gjithçka do zgjidhet sa hap e mbyll sytë. Beqaret do realizojnë plot takime, por asnjë nuk do jete ashtu si ata e kishin pritur. Nuk do e ndryshojnë dot statusin. Në planin financiar duhet të dëgjoni gjithmonë këshillat e me të mëdhenjë në mënyrë që të mos keni vështirësi.

**Shigjetari**  
Pas një periudhe delikate që keni kaluar në jetën tuaj në çift, sot me në fund do rilindë dielli. Komunikimi do rivendoset serish mes jush dhe atij që keni në krah. Beqareve do ju duhet të persin edhe pak kohe për të gjetur princin e tyre të kaltrë. Në planin financiar nuk duhet të bëni asnjë çmenduri sepse situata mund t'u dale menjëherë jashtë kontrollit.

**Bricjapi**  
Jeta juaj në çift nuk do ece me si me pare sot dhe problemet me partnerin do jene të njëpasnjëshme. Mendohuni mire për atë që doni të bëni dhe merrni vendime. Beqaret do arrijnë ta bëjnë për vete personin që kane kohe që e kane simpatizuar. Financat do vazhdojnë të mbeten shume të mira. Përfitorni për të shlyer të gjitha borxhet që keni marrë me herët.

**Ujori**  
Venusi do ua zbukurojë edhe me shume jetën tuaj në çift sot. Me partnerin do merreni vesh për gjithçka dhe do jeni gati për të bërë ndonjë çmenduri te vogël. Beqaret do fillojnë një lidhje të qëndrueshme e cila do ju sjellë plot të mira. Në planin financiar do keni goxha probleme dhe kjo për shkak të pakujtesisë që keni treguar kohë e fundit. Mësoni nga gabimet dhe rregullojeni situatën.

**Peshqit**  
Venusi do e privilegjojë jetën tuaj në çift gjatë gjithë kësaj dite. Do e çoni edhe me tej lidhjen që keni krijuar duke marrë vendime goxha të rëndësishme. Beqaret do jene te pagatë për atë që duan të bëjnë dhe nuk do guxojnë të hedhin hapa. Financat do jene shume të paqëndrueshme dhe problematike. Kujdes me hapat që do hidhni sepse mund të mbeten edhe pa para.

## FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHET TË NXINI 34 KUTI

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
1																	
2																	
3																	
4																	
5																	
6																	
7																	
8																	
9																	
10																	
11																	
12																	

### HORIZONTAL

- Thurin ode.
- Kush është... nuk është aspak aktiv.
- Fillojnë detyrën.
- Shyrt që që aktor.
- Ente Kërkimore Kombëtare
- Qe burni i parë.
- Kufizojnë paslet.
- Kurohen me kininë.
- Teket e një takse.
- Janë skuadrat Inter e Milan
- Zari këngëtare.
- I keni në derë.
- Merrn nga kamerieri.
- Janë edhe ato përdhese.
- Përpunojnë naftën.
- Qe kambist i dikurshëm.
- Ato të zhvillimit u takojnë qeverive.
- Kush është di të flasë.
- Gjysmë racion.
- Fillojnë temën.
- Është lloj papagalli.
- Ekstremë në elektreme.
- Mbeten në fund.
- Kryeqyteti i Filipineve.
- Nuk takohen kurrë.
- Martet pa kutij.
- Është djale i Priamit që u vra nga Akili.
- Një rrjetë në tenis
- Janë ekspertë.

### VERTIKAL

- Harold dramaturg nobelist.
- Writen nga espada.
- Të parat në olimpiadë.
- Një peshk liqeni.
- Efekt... i François Truffaut.
- Irlanda në Dublin.
- Një pjesë e formacionit.
- Këndon Laura non c'è.
- Gjysmë tati.
- Lau duart me Jezusin.
- Mario që që regjisor.
- Janë pozitivë.
- Është shteti i ndarë nga feja.
- Merrn me ushqimet.
- Kufizojnë kënde.
- Është muzika me ouverturë.
- Metheny kitarit.

- Janë pamje... nga puna.
9. Tartari pianiste.
- Gendër në kaos.
- Janë faqe muri.
- Është si mballoomë.
- Institucione Zyrtare ekonomike.
- Nin shkirimtare.
- Anita këngëtare.
- Julien i E kujia dhe e zeza.
- Një mendim.
- Janë aromatike të tilla mente.
- Një mmund të jetë përdhes.
- Është tokë e puneshme.
- Ivan Lendi.
- Shteti i Francezëve
- Markë cigaresh.
- Fillojnë ditën.
- Daniël që shkroi MollFlanders
- Mbajtesja e topit në golf.
- Shoqërorin Panin.
- Kufizojnë takimet

A	R	A	R	A	T	P	S	T	I	R	E	N	A	T
A	F	I	E	V	I	T	A	A	T	O	M	I	K	
H	A	T	T	E	L	A	T	S	T	A	T	A		
C	A	T	O	T	A	L	I	T	A	R	E	A	P	
O	R	P	E	R	I	F	E	R	I	T	E	F	N	A
H	E	R	E	M	I	T	N	E	N	P	A	T	E	
E	M	I	L	E	N	T	A	B	A	E	P	I		
N	V	E	F	A	E	K	R	R	A	S	A	T		
H	A	R	R	I	S	T	L	E	T	R	A	R	E	
C	I	L	I	N	D	E	R	M	O	T	E	R	A	T
E	D	E	N	I	N	R	I	T	O	A	K	T	E	
L	I	A	N	A	D	I	O	M	E	N	A	P	E	T

**Përgjigje e fjalëkryqit pa skemë**

## FJALËKRYQI SPORTIV

	1	2	3	4	5	6	7	8	9
10									
18									
19									
20									
21									
22									
23									
24									
25									
26									
27									
28									
29									
30									
31									
32									
33									
34									
35									
36									
37									
38									
39									
40									
41									
42									
43									

### HORIZONTAL

- Oerter ish-kampion i hedhjes së diskut.
- Nasri te Manchester City.
- Pak reumatizmë.
- Ricardo, që që portier legjendar spanjoll.
- Pak lutarakë.
- Fillojnë njëzëri.
- Kufizojnë një zabel.
- Diku në qendër.
- Mbrojtës francez.
- Në hyrje të sallës.
- Andrea aktore.
- Personazhi në foto.

- Gendër mësimi.
- Personzhi në foto.
- Lemond, ish-kampion i ciklizmit.
- Kufizojnë lëvizjet.
- Unë dhe ti.
- Janë dyluftimet.
- Fillojnë lejen.

- Minga i paharruar i futbollit tonë.
- ... devils, siç thirren lojtarët e Manchester Utd.
- Ferdinand mbrojtës anglez.
- Ente Antonone Lokale.
- Dajda trener.

## Sudoku

	3		5		1			7
7		6	3	9	2	4		1
	1	2		8				5
1	2		6		7		9	4
	7	3				1	6	
4	6		2		8		3	7
	8			7				4
3		7	4	2	5	6		8
	4		8		9			2

### Përgjigje

1	8	7	9	5	3	4	6	2
5	3	2	7	6	4	9	1	8
4	6	9	2	1	8	7	5	3
9	2	1	5	3	7	8	4	6
8	4	3	1	2	6	5	9	7
6	7	5	8	4	9	2	3	1
2	5	4	6	7	1	3	8	9
3	9	6	4	8	2	1	7	5
7	1	8	3	9	5	6	2	4

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo rresht e kolonë të ketë numrat nga 1-9

## FJALEKRYQI I KRYPTOGRAFUAR

### Përgjigje

L	I	P	A	M	A	M	A	N	I
L	E	N	O	N	E	R	A	N	I
U	L	E	N	A	D	I	O	M	E
M	E	R	A	R	I	S	T	A	T
A	R	A	R	I	S	T	A	T	A
A	R	R	I	S	T	L	E	T	R
M	A	J	L	E	S	J	A		
L	I	P	A	M	A	N	I		
L	O	N	E	R	A	N	I		
L	I	P	A	M	A	N	I		
L	E	N	O	N	E	R	A	N	I
L	E	N	O	N	E	R	A	N	I

SHKRONJA E NJËTË PËR NJËMËR TË NJËTË

9	L	O	R	D	5	10											
18					3												
10	2	4	1	8	1	3											
13	18	16	12	14	11	6	5	1	3	14	6						
5	9	3	16	12	2	4	18	10	14								
16	2	13	15	1	1	17	18	1	10	14							
15	9	2	17	18	2	13	8			11							
3	4	3	4	2	2	2	4	4	6								
13	18	10			1	5	6		3	9	5	3					
4	17	2	1	8	9	3			4	8	14	1					
6	16	5	2	4	2	9	3	1	11								
4	5	18	4	8	1	3	4		6	6	1						

### Përgjigje e fjalëkryqit sportiv

A	C	B	A	R	C	E	L	O	N	A
A	G	I	M	A	L	E	S	I	O	
R	I	A	B	O	C	H	E	S	T	I
D	R	O	G	B	A	L	E	T	I	
D	E	L	S	E	R	G	I	O	B	A
A	M	S	E	R	G	I	O	B	A	
N	I	P	A	I	A	D	I			
I	L	L	P	O	B	I	C	A	J	
E	A	R	T	I	A	C	O	S	E	
L	U	S	I	M	I	L	I	T	O	A

- Sir Charles, ish as i NBA.

### VERTIKAL

- Një pjesë e aziatikëve.
- Armstrong ish-çiklist (inic).
- Të parat në sondazh.
- Mbyllin një sirtar.
- Ei Pibe de Oro i futbollit.
- Një Gjergji meshfushor i yni.
- Terhati ish-volejbolli.
- Samir portier i yni.
- Lippi trener.
- Një pulizë freskë.
- Dovana ku luan Teuta.
- Ente Informative Belge.
- Është Topi i CR7
- Centrale Rajonale Turke.
- Aktorja e filmit "10".
- De Rossi te Roma.
- Indurain, ish as i çiklizmit.
- Federer tenist.
- Një pjesë e relacionit.
- Jupi ish-meshfushor.
- Gjysma e dritës.
- Pak balistike.
- Fise pa te.
- Derisa janë në fund.

Rajoni

SERBI

# Sheshel: Nuk kthehem në Hagë, të ikin Nikoliç-Vuçiç!

## I akuzuari për krime lufte sulmon presidentin, kryeministrin dhe ministrin e Jashtëm

**K**ryetari i Partisë Radikale Serbe (SRS) dhe i akuzuari i Hagës Vojislav Sheshel, në prani të mediave në Beograd dhe shpalli publikisht se nuk do të kthehet vullnetarisht në paraburgimin e Tribunalit të Hagës. I akuzuari për krime lufte nga më të rëndat, gjithashtu tha se do të iniciojë një mocion për shkarkimin e Presidentit të Serbisë, Tomislav Nikoliç. Sheshel u tha gazetarëve në selinë e SRS se këtë iniciativë e mbështet në argumente, sipas të cilave Nikoliç ka shkelur Kushtetutën pasi ka një diplomë të paligjshme universiteti dhe po shërben vetëm si zëdhënës të Fondacionit të gruas së tij Dragica Nikoliç.

"Ne do të mbledhim firmat, të vetëdijshëm se vetëm nuk mund të arrijmë asgjë. Shpresojmë që të ndikojmë

në aq deputetë, sa të jenë të mjaftueshëm për diskutim në Asambleen Kombëtare, sepse opinioni ka të drejtë për një gjë të tillë", tha Sheshel. "Nëse më arrestojnë dhe më dorëzojnë tek autoritetet gjyqësore, le të më tërheqin zvarrë deri në avion".

Ai gjithashtu ftoi kryeministrin serb Aleksandër Vuçiç në një duel televiziv. "Vazh-

dimisht dhe publikisht ftoj Aleksandar Vuçiç në duel televiziv të drejtpërdrejtë, në kanal kombëtar që ta zgjedhë ai vetë, për një debat mbi çështjet politike", pohoi Sheshel. Vuçiç për shumë vite ka qenë sekretar i përgjithshëm i SRS.

Udhëheqësi radikal gjithashtu akuzoi zëvendëskryeministrin dhe shef

i diplomacisë serbe, Ivica Daçiç, për lidhje me qarqet kriminale gjatë kohës kur mbajti postin e ministrit të Punëve të Brendshme.

Gjykata e Hagës më 6 nëntor vendosi që Vojislav Sheshel të lirohet përkohësisht për trajtim mjekësor. Pas kësaj, më 12 nëntor ai u kthye në Serbi. Gjykata Ndërkombëtare Penale për



Kryetari i Partisë Radikale Serbe, Vojislav Sheshel

ish-Jugosllavinë ngriti padi kundër Sheshelit në janar 2003 për krime lufte në Kroatia, Bosnjë e Hercegovinë dhe Vojvodinë. Ai është i akuzuari për persekutim mbi baza politike, racore dhe fetare në Sllavoninë lindore dhe perëndimore, Bosnjë e Hercegovinë dhe pjesë të Vojvodinës, duke përfshirë vrasjet në Vukovar, në rrethinat e Sarajevës, Mo-

star, Nevesinje dhe Zvornik, për burgimin e civilëve në kampet e përqendrimit në kushte çnjerëzore, tortura, rrahje dhe vrasje, dëbim e shpërngulje të dhunshme të dhjetëra mijëra kroatëve dhe myslimanëve. Po ashtu, edhe për shkatërrimin me dashje të shtëpive të tyre, pronës, objekteve kulturore dhe objekteve fetare.

© 2014 The Coca-Cola Company. Coca-Cola është markë e regjistruar e The Coca-Cola Company.

Më shumë lumturi në tryezën tënde

Tani vetëm

**120** lekë

\*çmimi i rekomanduar

për formatet 1,5 L

Për më shumë informacion, vizito [www.ccbsa.al](http://www.ccbsa.al) ose telefono në +35545606060 Promocioni përfundon më 7 Janar 2015, ose në përfundim të produktit promocional.

Alba Malltezi - Drejtore e Përgjithshme e Free and Fair Media Group ; Aurel Pepa - Zv/kryeredaktor  
Genc Kondi - Administrator i Përgjithshëm e Ekonomi ; Admirina Peçi - Kryeredaktore e "Rilindasi" ; Politika: Lujxin Mustafaraj ; Aktualitet: Elton Qyno ; Sociale: Sonila Isaku ; Kulturë: Dhurata Hamzai ; Sporti: Dylber Balla ; Design: Altin Aliaj, Erjon Ymeri ; Website: Greta Malaj ; Shpërndarja: Spiro Meshini cel: +355696088847

Departamenti i Marketingut:  
Vera Përleka  
Cel: +355696060419  
[marketing@shqiptarja.com](mailto:marketing@shqiptarja.com)

Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë-Tiranë. E-mail: [redaksia@shqiptarja.com](mailto:redaksia@shqiptarja.com) - Website: [www.shqiptarja.com](http://www.shqiptarja.com) - Mobile: +355696060421 - Shtypur në shtypshkronjën: KLASS shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë